European Commission



# DigComp 2.1:

# Korniza e kompetencës digjitale për qytetarët

## Me tetë nivele të aftësisë dhe shembuj të përdorimit

Autorët: Stephanie Carretero, Riina Vuorikari and Yves Punie

EUR 28558 EN

Qendra e Përbashkët për Kërkime

DigComp 2.1

# Korniza e kompetencës digjitale për qytetarët

## Me tetë nivele të aftësisë dhe shembuj të përdorimit

Autorët:
Stephanie Carretero, Riina Vuorikari dhe Yves Punie

Ky publikim është një raport i Shkencës për politikat nga Qendra e Përbashkët për Kërkime (JRC), shërbimi për shkencë dhe njohuri i Komisionit Evropian. Qëllimi i tij është ofrimi i mbështetjes për procesin e politikave evropiane përmes dëshmive shkencore. Rezultatet shkencore të shprehura nuk nënkuptojnë qëndrimin e politikave të Komisionit Evropian. As Komisioni Evropian e as ndonjë person që vepron në emër të Komisionit Evropian nuk është përgjegjës për përdorimin që mund t'i bëhet këtij publikimi.

## Mirënjohje

Jemi mirënjohës ndaj palëve që dhanë kontribut dhe na ndihmuan për formësimin e DigComp 2.1 gjatë një periudhe mbi njëvjeçare. Falënderime të veçanta për të gjithë ata që ofruan ekspertizën e tyre në procesin e validimit të DigComp 2.1, në veçanti për Monique Derrider (Katholiek Onderwijs Vlaanderen, Belgjikë), Jim Devine (expert i pavarur, Irlandë), George Evangelinos (Anglia Ruskin University, MB), Gloria García Amat (Fernando de los Ríos Consortium, Spanjë), Itziar Garcia Blazquez (expert i pavarur, Spanjë), Jean-Yves Jeannas (expert i pavarur, Francë), Jesús Moreno (expert i pavarur, Spanjë), Uwe Richter (Anglia Ruskin University, MB), Anelia Stoikova (experte e pavarur, Bullgari), Esther Subias (El Teb, Spanjë) dhe Ryszard Wos (Fondacioni ECCC, Poloni).

## Gjithashtu, duam të falënderojmë:

Kolegët tanë Margherita Bacigalupo, Christine Redecker dhe Pan Kampylis nga ekipi ynë për mësimin dhe shkathtësitë në JRC, që morën pjesë në zhvillimin e kornizës dhe pasurimin e saj duke ofruar reagimet dhe komentet e tyre.

William Okeeffe nga DG EMPL për rishikimin dhe komentet.

Patricia Farrer (JRC) për lektorimin dhe redaktimin.

Emiliano Bruno (JRC) për koordinimin e konsultimit editorial.

Massimiliano Fucci (JRC) për dizajnin dhe strukturën e raportit.

Rubén Jiménez El Rubencio për ilustrimet.

Ne besojmë se të gjithë kanë dhënë kontribut domethënës për t'i mundësuar JRC-së që ta prezantojë raportin aktual.

## Informacionet e kontaktit

Emri: Yves Punie
Emaili: yves.punie@ec.europa.eu

## Qendra shkencore e JRC

https://ec.europa.eu/jrc

JRC106281
EUR 28558 EN

| | | | |
|---|---|---|---|
| PDF | ISBN 978-92-79-68006-9 | ISSN 1831-9424 | doi:10.2760/38842 |
| Print | ISBN 978-92-79-68005-2 | ISSN 1018-5593 | doi:10.2760/836968 |

Luksemburg: Zyra e publikimeve të Bashkimit Evropian, 2017
© European Union, 2017

Ripërdorimi i dokumentit lejohet, me kusht që burimi të citohet dhe kuptimi ose mesazhi origjinal i teksteve të mos shtrembërohet. Komisioni Evropian nuk do të mbahet përgjegjës për pasojat që dalin nga ripërdorimi.

Si të citohet ky raport: Carretero, S.; Vuorikari, R. and Punie, Y. (2017). DigComp 2.1: The Digital Competence Framework for Citizens with eight profi- ciency levels and examples of use, EUR 28558 EN, doi:10.2760/38842

Të gjitha imazhet © European Union 2017, përveç: [Ilustrimet në kopertinë dhe në faqe 14-15-19-20, El Rubencio (Spanjë), elrubencio@elrubencio.com]

## Titulli:

DigComp 2.1: Korniza e kompetencës digjitale për qytetarët me tetë nivele të aftësisë dhe shembuj të përdorimit

## Abstrakt

DigComp 2.1 është zhvillim i mëtejshëm i Kornizës së kompetencës digjitale për qytetarët. Bazuar në modelin konceptual të referimit të publikuar në DigComp 2.0, tani prezantojmë tetë nivele të aftësisë dhe shembuj të përdorimit të aplikuar në fushën e mësimit dhe punësimit.

DigComp 2.1

# Korniza e kompetencës digjitale për qytetarët

## Me tetë nivele të aftësisë dhe shembuj të përdorimit

# Parathënie

Kërkimet e JRC-së për Mësimin dhe shkathtësitë në epokën digjitale filluan në vitin 2005 me qëllim ofrimin e mbështetjes për politikat bazuar në dëshmi për Komisionin Evropian dhe Shtetet anëtare për shfrytëzimin e potencialit të teknologjive digjitale për të prezantuar praktika novatore mësimi dhe trajnimi, për të përmirësuar qasjen në mësimin gjatë gjithë jetës dhe për t'u marrë me rritjen e shkathtësive dhe kompetencave të reja (digjitale) të nevojshme për punësim, zhvillim personal dhe përfshirje sociale. Më shumë se 20 studime shkencore janë ndërmarrë për këto çështje me më shumë se 100 publikime të ndryshme.

Korniza Evropiane e kompetencës digjitale për qytetarët[1], e njohur edhe si DigComp, ofron një mjet për të përmirësuar kompetencën digjitale të qytetarëve. DigComp u zhvillua nga JRC-ja si projekt shkencor dhe me konsultimin intensiv të palëve të interesit, fillimisht në emër të DG EAC dhe, së fundi, në emër të DG EMPL. E publikuar për herë të parë në vitin 2013, DigComp është bërë referim për zhvillimin dhe planifikimin strategjik të nismave të kompetencës digjitale në nivel evropian dhe të Shteteve anëtare. Në qershor 2016, JRC-ja publikoi DigComp 2.0, duke e përditësuar terminologjinë dhe modelin konceptual, si dhe duke dhënë shembuj të zbatimit në nivel evropian, nacional dhe rajonal.

Versioni aktual është emëruar DigComp 2.1 dhe fokusohet në zgjerimin e tri niveleve fillestare të aftësisë në një përshkrim më të detajuar me tetë nivele, si dhe ofron shembuj të përdorimit për këto tetë nivele. Qëllimi i saj është të mbështesë palët e interesit për zbatimin e mëtejmë të DigComp.

Punime të tjera të ndërlidhura të JRC-së për ndërtimin e kapaciteteve për transformimin digjital të arsimit dhe mësimit dhe për ndryshimin e kërkesave për shkathtësitë dhe kompetencat janë fokusuar në zhvillimin e:

[1] Më shumë informacion mund të gjeni në: https://ec.europa.eu/jrc/en/digcomp

- kornizave të kompetencës digjitale për edukatorët (DigCompEdu),
- organizatat arsimore (DigCompOrg),
- konsumatorët (DigCompConsumers).

Një kornizë për hapjen e Institucioneve të Arsimit të Lartë (OpenEdu) u publikua gjithashtu në vitin 2016, si dhe një kornizë e kompetencës për ndërmarrësi (EntreComp). Disa nga këto korniza shoqërohen me instrumente të vlerësimit (vetë-vlerësimit). Kërkime shtesë janë ndërmarrë për mendimin informatik (CompuThink), Analitikën e të nxënit (Learning Analytics), nxënësit e MOOC (MOOCKnowledge) dhe kurset MOOCs dhe mundësitë falas për mësim digjital për emigrantët dhe refugjatët (MOOCs4inclusion).

Më shumë informacion nga të gjitha studimet tona mund të gjenden në Qendrën shkencore të JRC-së: https://ec.europa.eu/jrc/en/research-topic/learning-and-skills

Yves Punie

Udhëheqëse e projektit

DG JRC Njësia e kapitalit njerëzor dhe punësimit

Komisioni Evropian

DigCompEdu: https://ec.europa.eu/jrc/en/digcompedu
DigCompOrg: https://ec.europa.eu/jrc/en/digcomporg
DigCompConsumers: https://ec.europa.eu/jrc/en/digcompconsumers
OpenEdu: https://ec.europa.eu/jrc/en/open-education
EntreComp: https://ec.europa.eu/jrc/en/entrecomp
CompuThink: https://ec.europa.eu/jrc/en/computational-thinking
Learning Analytics: http://europa.eu/!cB93Gb
MOOCKnowledge: http://moocknowledge.eu
MOOCs4inclusion: http://moocs4inclusion.org

# Tabela e përmbajtjes

Seksioni 1
Hyrje 10

Seksioni 2
Tetë nivelet e aftësisë dhe shembuj të përdorimit 12

Seksioni 3
Kompetencat 21

Fusha e kompetencës 1: Informacionet dhe njohja e të dhënave 23

Fusha e kompetencës 2: Komunikimi dhe bashkëpunimi 26

Fusha e kompetencës 3: Krijimi i përmbajtjes digjitale 32

Fusha e kompetencës 4: Siguria 36

Fusha e kompetencës 5: Zgjidhja e problemeve 40

Seksioni 1

# Hyrje

Ky raport është versioni i fundit i Kornizës së kompetencës digjitale për qytetarët (DigComp)[2] që u elaborua nga Njësia e Kapitalit njerëzor dhe Punësimit (Qendra e Përbashkët për Kërkime) në emër të Drejtorisë Gjenerale për Punësim, Çështje sociale dhe Përfshirje e Komisionit Evropian.

Korniza DigComp ka 5 dimensione:

**Dimensioni 1:** Fushat e kompetencës të identifikuara si pjesë e kompetencës digjitale

**Dimensioni 2:** Përshkruesit e kompetencës dhe titujt që janë relevantë për secilën fushë

**Dimensioni 3:** Nivelet e aftësisë për secilën kompetencë

**Dimensioni 4:** Njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e aplikueshme për secilën kompetencë

**Dimensioni 5:** Shembuj të përdorimit për aplikueshmërinë e kompetencës për qëllime të ndryshme

Dy nga dimensionet në versionin e mëparshëm të Kornizës (DigComp 1.0 i publikuar në vitin 2013) janë përditësuar në vitin 2016, gjegjësisht Dimensioni 1 (fushat e kompetencës) dhe Dimensioni 2 (përshkruesit dhe titujt). Versioni i përditësuar u bë DigComp 2.0[3]. Ky raport paraqet versionin më të fundit të Kornizës – DigComp 2.1 – që përfshin përditësime të mëtejshme. Dimensioni 3 ka tani tetë nivele të aftësisë dhe Dimensioni 5 ka shembuj të ri të përdorimit[4].

Seksioni 2 i këtij raporti shpjegon tetë nivelet e aftësisë dhe përshkruan shembujt e përdorimit. Seksioni 3 paraqet në detaje Kornizën e re. Përpjekje të konsiderueshme i janë dedikuar strukturës dhe paraqitjes grafike të DigComp 2.1 për të rritur lexueshmërinë për të gjitha palët e interesit të interesuara për zbatimin e kornizës. Si rikujtesë, në faqen vijuese prezantohet një përmbledhje e DigComp 2.0, ku tregohen ndryshimet për DigComp 2.1.

2 Informacione për DigComp: https://ec.europa.eu/jrc/en/digcomp
3 DigComp 2.0 është në dispozicion në: http://europa.eu/!HV34YF
4 DigComp 2.1 nuk përfshin përditësimin e dimensionit 4; ne preferojmë fokusimin në shembujt e përdorimit të aplikuar në fushën e punësimit dhe mësimit për shkak të relevancës së tyre për politikat.

| DigComp 2.0 (viti 2016) | | DigComp 2.1 (viti 2017) | |
|---|---|---|---|
| Fushat e kompetencës (dimensioni 1) | Kompetencat (dimensioni 2) | Nivelet e aftësisë (dimensioni 3) | Shembujt e përdorimit (dimensioni 5) |
| 1. Informacionet dhe njohja e të dhënave | 1.1 Shfletimi, kërkimi dhe filtrimi i të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale<br>1.2 Vlerësimi i të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale<br>1.3 Menaxhimi i të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale | Tetë nivelet e aftësisë për secilën nga 21 kompetencat | Shembuj të përdorimit të tetë niveleve të aftësisë të aplikuar në skenarë të mësimit dhe punësimit në 21 kompetencat |
| 2. Komunikimi dhe bashkëpunimi | 2.1 Ndërveprimi nëpërmjet teknologjive digjitale<br>2.2 Ndarja nëpërmjet teknologjive digjitale<br>2.3 Angazhimi në qytetari nëpërmjet teknologjive digjitale<br>2.4 Bashkëpunimi nëpërmjet teknologjive digjitale<br>2.5 Normat e komunikimit në internet<br>2.6 Menaxhimi i identitetit digjital | | |
| 3. Krijimi i përmbajtjes digjitale | 3.1 Zhvillimi i përmbajtjes digjitale<br>3.2 Integrimi dhe rielaborimi i përmbajtjes digjitale<br>3.3 Të drejtat e autorit dhe licencat<br>3.4 Programimi | | |
| 4. Siguria | 4.1 Mbrojtja e pajisjeve<br>4.2 Mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësisë<br>4.3 Mbrojtja e shëndetit dhe mirëqenies<br>4.4 Mbrojtja e mjedisit | | |
| 5. Zgjidhja e problemeve | 5.1 Zgjidhja e problemeve teknike<br>5.2 Identifikimi i nevojave dhe përgjigjeve teknologjike<br>5.3 Përdorimi kreativ i teknologjive digjitale<br>5.4 Identifikimi i mangësive në kompetencën digjitale | | |

Seksioni 2

# Tetë nivelet e aftësisë dhe shembuj të përdorimit

Korniza DigComp 1.0 kishte tri nivele të aftësisë në Dimensionin 3 (bazë, i ndërmjetëm dhe i përparuar). Këto tani janë zgjeruar në tetë nivele në DigComp 2.1. Një gamë më e gjerë dhe më e detajuar e niveleve të aftësisë mbështet zhvillimin e mësimit dhe materialeve të trajnimit. Po ashtu ndihmon në hartimin e instrumenteve për vlerësimin e kompetencës së qytetarëve, orientimin në karrierë dhe promovimin në punë.

Tetë nivelet e aftësisë për secilën kompetencë janë përkufizuar përmes rezultateve të të nxënit (duke përdorur folje veprimi, sipas taksonomisë së Bloom) dhe janë frymëzuar nga struktura dhe fjalori i Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (EQF). Për më shumë, përshkrimi i secilit nivel përmban njohuri, shkathtësi dhe qëndrime, të përshkruara në një përshkrues të vetëm për çdo nivel të secilës kompetencë; kjo do të thotë se janë 168 përshkrues (8 x 21 rezultate të të nxënit). Një anketë validimi në linjë ndihmoi për të rishikuar versionin e parë të niveleve dhe përpilimin e versionit final.

Siç shihet në Tabelën 1 në faqen vijuese, secili nivel paraqet një hap në përvetësimin e kompetencës nga qytetarët sipas sfidave kognitive, kompleksitetit të detyrave që ata të mund të menaxhojnë dhe autonomisë së tyre në përfundimin e detyrave. Për ta ilustruar këtë pikë, mund të themi se një qytetar në nivelin 2 është në gjendje të mbajë mend dhe të kryejë një detyrë të thjeshtë me ndihmë nga dikush që ka kompetencë digjitale vetëm kur atij/asaj i duhet ndihmë. Një qytetar në nivelin 5, megjithatë, mund të aplikojë njohuri, të kryejë detyra të ndryshme dhe të zgjidhë probleme dhe të ndihmojë po ashtu të tjerët për ta bërë këtë. Ne mund të shohim po ashtu se gjashtë nivelet e para të aftësisë në Kornizën e re janë të lidhura me tri nivelet e identifikuara fillimisht në DigComp 1.0. Një nivel tejet i specializuar është shtuar në versionin e fundit të Kornizës që përfshin nivelet shtatë dhe tetë. Informacioni në Tabelën 1 (faqe 13) është paraqitur në mënyrë grafike në infografikë në faqe 14 dhe 15.

Tabela 1: Fjalët kyçe kryesore që karakterizojnë nivelet e aftësisë

| Nivelet në DigComp 1.0 | Nivelet në DigComp 2.1 | Kompleksiteti i detyrave | Autonomia | Domeni kognitiv |
|---|---|---|---|---|
| Bazë | 1 | Detyra të thjeshta | Me udhëzime | Mbajtja mend |
| | 2 | Detyra të thjeshta | I pavarur, me udhëzime kur është e nevojshme | Mbajtja mend |
| I ndërmjetëm | 3 | Detyra të përkufizuara mirë dhe rutinore dhe probleme të drejtpërdrejta | Vetë | Të kuptuarit |
| | 4 | Detyra dhe probleme të përkufizuara mirë dhe jorutinore | I pavarur dhe sipas nevojave të mia | Të kuptuarit |
| I përparuar | 5 | Detyra dhe probleme të ndryshme | Udhëzime për të tjerët | Aplikimi |
| | 6 | Detyrat më të përshtatshme | Në gjendje të përshtatet me të tjerët në një kontekst kompleks | Vlerësimi |
| Tejet i specializuar | 7 | Zgjidhja e problemeve komplekse me zgjidhje të kufizuara | Integrimi për të kontribuuar në praktikën profesionale dhe për të ndihmuar të tjerët | Krijimi |
| | 8 | Zgjidhja e problemeve komplekse me shumë faktorë ndërveprues | Propozon ide dhe procese të reja në fushë | Krijimi |




KOMPLEKSITETI I DETYRAVE | AUTONOMIA | DOMENI KOGNITIV

## I PËRPARUAR

### Niveli 5

- DETYRA DHE PROBLEME TË NDRYSHME
- UDHËZIMI I TË TJERËVE
- APLIKIMI

### Niveli 6

- DETYRAT MË TË PËRSHTATSHME
- NË GJENDJE PËR T'IU PËRSHTATUR TË TJERËVE NË NJË KONTEKST KOMPLEKS
- VLERËSIMI

## TEJET I SPECIALIZUAR

### Niveli 7

- ZGJIDHJA E PROBLEMEVE KOMPLEKSE ME ZGJIDHJE TË KUFIZUARA
- INTEGRIMI PËR TË KONTRIBUAR NË PRAKTIKËN PROFESIONALE DHE UDHËZIMIN E TË TJERËVE
- KRIJIMI

### Niveli 8

- ZGJIDHJA E PROBLEMEVE KOMPLEKSE ME SHUMË FAKTORË NDËRVEPRUES
- PROPOZIMI I IDEVE DHE PROCESEVE TË REJA NË FUSHË
- KRIJIMI



ED &
S

OS

Figura 1 më poshtë ofron një shpjegim të detajuar lidhur me mënyrën e prezantimit të kompetencave në Seksionin 3 të këtij raporti.

- **Fushat e kompetencës** (dimensioni 1) dhe **Titulli i kompetencës** dhe **Përshkruesi i kompetencës** (dimensioni 2) shfaqen në banderolën vertikale, ngjyra e së cilës ndryshon varësisht nga fusha e kompetencës
- Rreshti i parë tregon emrat e **8 niveleve të aftësisë** (dimensioni 3) sipas versionit 2.1 (niveli 1, niveli 2 etj.). Paralelisht, tregohet edhe emri i niveleve sipas DigComp 1.0 (Bazë, I ndërmjetëm etj.).
- Në rreshtin e dytë, mund të shohim përshkrimin për secilin nivel të aftësisë lidhur me kompleksitetin e detyrave dhe problemeve dhe nivelin e autonomisë, së bashku me përshkrimin e kompetencës në aspektin e rezultateve të të nxënit. Secila pikë i përgjigjet një përshkruesi të kompetencës dhe secila folje veprimi dhe fjalë kyçe është e theksuar me të zezë.

Figura 1: Shpjegimi se si janë paraqitur kompetencat



**Shembujt e përdorimit** (dimensioni 5 i kornizës) po ashtu janë përditësuar dhe janë kontekstualizuar në skenarë për dy fusha përdorimi: punësimi dhe mësimi. Këto ilustrojnë tetë nivelet e aftësisë për të ndihmuar me zbatimin e DigComp 2.1.

Siç mund të shihet në Seksionin 3 të këtij raporti, shembujt e përdorimit janë prezantuar si në vijim:

- Ne përfshijmë shembuj të niveleve të aftësisë në dy fusha përdorimi: punësimi dhe mësimi.
- Ne përfshijmë skenarë për secilën fushë të kompetencës dhe fushë të përdorimit me qëllim kontekstualizimin e shembujve.
- Kemi shembuj të elaboruar për të dy fushat e përdorimit në secilin nivel të aftësisë. Në këtë version 2.1, shembujt për 8 nivelet janë në dispozicion vetëm në kompetencën e parë (1.1), për pjesën tjetër të kompetencave ofrojmë një shembull për nivel dhe fushë të përdorimit[5].

  Për të dhënë shembuj në të njëjtin numër të niveleve të aftësisë dhe për të pasur numër të njëjtë të shembujve nëpër nivele, kemi ndjekur strategjinë e "ujëvarës": për një kompetencë kemi shkruar shembujt për një nivel dhe në kompetencën vijuese kemi shkruar shembullin në nivelin vijues e kështu me radhë. Për shembull, kompetencat 1.1 dhe 1.2 kanë një shembull për nivelin 1, kompetenca 1.3 për nivelin 2, kompetenca 1.4 për nivelin 3 etj.

Progresioni i niveleve të aftësisë së kompetencave, rezultatet e tyre të të nxënit dhe aplikimi praktik i shfaqur në "Shembujt e përdorimit" janë bërë më të kuptueshëm në tabelën në faqe 19 (Kompetenca 1.1).

5 Nuk ofrojmë shembuj për të gjitha nivelet e aftësisë, sepse natyra e kornizës është përshkruese dhe qëllimi i tyre është ilustrimi i niveleve të aftësisë.

Janë përdorur tregime vizatimore për të treguar një shembull përdorimi për një skenar punësimi dhe një shembull përdorimi për një skenar mësimi në kompetencën 1.1.

Më konkretisht, tregimet vizatimore lejojnë që përdoruesi të kuptojë më lehtë progresionin e përvetësimit të një kompetence digjitale, dhe si rrjedhim është një mbështetje për palët që dëshirojnë ta zbatojnë kornizën.

Nivelet e aftësisë

Shembuj të përdorimit

01 Skenari i punësimit:

Procesi i kërkimit për punë

## Bazë

### 1

Në nivel bazë dhe me udhëzime, unë mund të:

- **identifikoj** nevojat e mia për informacion,
- **gjej** të dhëna, informacione dhe përmbajtje përmes kërkimit të thjeshtë në mjedise digjitale,
- **gjej** se si të qasem në këto të dhëna, informacione dhe përmbajtje dhe të navigoj ndërmjet tyre,
- **identifikoj** strategji **të thjeshta** personale të kërkimit.

Me ndihmën e këshilltares së punësimit:

Mund të identifikoj, nga një listë, ato portale të vendeve të punës që mund të më ndihmojnë të kërkoj për një punë.

Po ashtu mund t'i gjej këto portale pune në dyqanin e aplikacioneve në telefonin tim të mençur dhe të qasem dhe të navigoj ndërmjet tyre.

Nga një listë e fjalëve kyçe të përgjithshme për kërkimin e vendeve të punës në dispozicion në një blog për vende pune, mund të identifikoj fjalët kyçe që janë të dobishme për mua.




### 2

Në nivel bazë dhe i pavarur dhe me udhëzime të duhura kur është e nevojshme, unë mund të:

- **identifikoj** nevojat e mia për informacion,
- **gjej** të dhëna, informacione dhe përmbajtje përmes kërkimit të thjeshtë në mjedise digjitale,
- **gjej** se si të qasem në këto të dhëna, informacione dhe përmbajtje dhe të navigoj ndërmjet tyre,
- **identifikoj** strategji të thjeshta personale të kërkimit.

Me ndihmën e këshilltares së punësimit nëse është e nevojshme:

Mund të identifikoj, nga një listë, ato portale të vendeve të punës që mund të më ndihmojnë të kërkoj për një punë.

Po ashtu mund t'i gjej këto portale pune në dyqanin e aplikacioneve në telefonin tim të mençur dhe të qasem dhe të navigoj ndërmjet tyre.

Nga një listë e fjalëve kyçe të përgjithshme për kërkimin e vendeve të punës në dispozicion në një blog për vende pune, mund të identifikoj fjalët kyçe që janë të dobishme për mua.



## I ndërmjetëm

### 3

Në mënyrë të pavarur dhe duke zgjidhur probleme të drejtpërdrejta, unë mund të:

- **shpjegoj** nevojat e mia për informacion,
- **kryej** kërkime **të përkufizuara mirë dhe rutinore** për të gjetur të dhëna, informacione dhe përmbajtje në mjedise digjitale,
- **shpjegoj** se si mund të qasem në to dhe të navigoj ndërmjet tyre.
- **shpjegoj** strategji kërkimi personale **të përkufizuara mirë dhe rutinore.**

Vetë:

Mund të emërtoj portalet e punës që përdor zakonisht për të më ndihmuar që të kërkoj për punë.

Mund të përdor fjalë kyçe të përkufizuara mirë për të gjetur portale pune në dyqanin e aplikacioneve në telefonin tim të mençur dhe t'i shpjegoj këshilltares së punësimit se si qasem dhe navigoj ndërmjet tyre.

Mund t'i shpjegoj këshilltares së punësimit se pse përdor zakonisht fjalë të caktuara kyçe për të gjetur portale pune dhe aplikacione në telefonin tim të mençur.

Mund të rregulloj probleme si qasja në portale ose aplikacione pune të gabuara, ose navigimi jashtë portaleve që përdor zakonisht.



### 4

Në mënyrë të pavarur, sipas nevojave të mia, dhe duke zgjidhur probleme të përkufizuara mirë dhe jorutinore, unë mund të:

- **ilustroj** nevojat për informacion,
- **organizoj** kërkimet e të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes në mjediset digjitale,
- **përshkruaj** mënyrën e qasjes në këto të dhëna, informacione dhe përmbajtje dhe të navigoj ndërmjet tyre,
- **organizoj** strategji personale të kërkimit.

Mund t'i jap këshilltares së punësimit shembuj të portaleve ose aplikacioneve të përshtatshme të punës që përdor për nevojat e mia të kërkimit për punë.

Mund të organizoj strategjinë time të kërkimit si përdorimi i fjalëve kyçe dhe kontrollimi i vlerësimit të aplikacioneve, për të gjetur aplikacione të përshtatshme në telefonin tim të mençur që i përshtaten profilit tim të kërkimit të punës.

Mund t'i përshkruaj këshilltares së punësimit se si mund të qasem në aplikacione dhe të navigoj ndërmjet aplikacioneve që kam gjetur përmes kësaj strategjie të organizuar të kërkimit.

Mund të organizoj një listë të fjalëve kyçe që janë të dobishme për të gjetur portale dhe aplikacione pune me oferta për punë që lidhen me profilin tim të punës në telefonin tim të mençur.

Ndërsa, kryej këto aktivitete, mund të zgjidh çështje si vlerësimi i aplikacioneve të reja që vijnë në dyqanin e aplikacioneve të telefonit tim të mençur si rezultat i kërkimit tim ose t'i shtoj fjalë kyçe të reja strategjisë sime personale të kërkimit.



## I përparuar

### 5

Përveç udhëzimit të të tjerëve, unë mund të:

- **përgjigjem** ndaj nevojave për informacione,
- **aplikoj** kërkimet për të përfituar të dhëna, informacione dhe përmbajtje në mjediset digjitale,
- **tregoj** mënyrën e qasjes në këto të dhëna, informacione dhe përmbajtje dhe të navigoj ndërmjet tyre.
- **propozoj** strategji personale të kërkimit.

Gjatë kërkimit të punës, mund të gjej portale dhe aplikacione që lidhen me profilin tim të punës në cilindo mjedis digjital, qoftë ato të zakonshme ose të reja (OS, aplikacione, pajisje).

Gjithashtu mund t'i tregoj një shoqes se si të gjej aplikacionet në telefonin e saj të mençur, duke përdorur fjalë kyçe të ndryshme dhe kriteret e vlerësimit për të zgjedhur ato që i përshtaten profilit të saj të punës.

Mund t'i shpjegoj se si të qaset dhe të navigojë ndërmjet këtyre aplikacioneve për të gjetur vendet e lira të punës që i përshtaten.

Mund t'i ofroj një shoqes këshillat e mia për kërkimin e punës, përfshirë fjalët kyçe, shpalljet për vende pune, bloget, aplikacionet dhe portalet që unë përdor kur kërkoj punë, dhe t'i ndaj me punëkërkuesit e tjerë.




### 6

Në nivel të përparuar, sipas nevojave të mia personale dhe të të tjerëve, dhe në kontekste komplekse, unë mund të:

- **vlerësoj** nevojat për informacione,
- **përshtat** strategjinë time të kërkimit për të gjetur të dhënat, informacionet dhe përmbajtjen **më të përshtatshme** në mjediset digjitale,
- **shpjegoj** mënyrën e qasjes te të dhënat, informacionet dhe përmbajtja **më e përshtatshme** dhe të navigoj ndërmjet tyre.
- ndryshoj strategjitë personale të kërkimit.

Mund të vlerësoj portalet më të përshtatshme të punës për vende të lira pune sipas nevojave të mia të kërkimit të punës dhe atyre të një shoqes.

Mund të gjej aplikacione të punës të adaptuara për nevojat e mia të kërkimit të punës dhe atyre të një shoqes. Mund të bëj dallimin midis aplikacioneve të duhura dhe jo të duhura, dhe informacioneve të reja ose të padëshirueshme ndërsa qasem dhe navigoj ndërmjet aplikacioneve.

Mund t'u shpjegoj punëkërkuesve të tjerë se si të bëj kërkime dhe mund të tejkaloj situatat e papritura që paraqiten në mjedisin digjital (të padëshiruara, portale pune joadekuate, probleme me shkarkimin etj.) për të gjetur oferta të përshtatshme pune në telefonin tim të mençur.

Mund të ndaj këshillat e mia për kërkimin e punës në të cilat përdor fjalë kyçe, shpalljet për vende pune, bloget, aplikacionet dhe portalet e përshtatura për profile të ndryshme pune dhe të jap shembuj se si të tejkalohen situatat komplekse gjatë kërkimit të punës (p.sh. mosgjetja e shpalljeve të duhura për vende pune, shpalljet e rreme ose të vjetra të vendeve të punës).




## Tejet i specializuar

### 7

Në nivel tejet të specializuar, unë mund të:

- **krijoj zgjidhje për probleme komplekse me përkufizim të kufizuar** që lidhen me shfletimin, kërkimin dhe filtrimin e të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale.
- **integroj** njohuritë e mia **për të kontribuar në praktikën dhe njohuritë profesionale dhe të udhëzoj të tjerët** për shfletim, kërkim dhe filtrim të të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale.

Mund të krijoj një platformë digjitale bashkëpunuese (blog, wiki etj.) e cila mund të përdoret nga punëkërkuesit për të shfletuar dhe filtruar portalet dhe ofertat e punës sipas nevojave të tyre të punëkërkimit.



### 8

Në nivelin më të përparuar dhe të specializuar, unë mund të:

- **krijoj zgjidhje për zgjidhjen e problemeve komplekse me shumë faktorë ndërveprues** që lidhen me shfletimin, kërkimin dhe filtrimin e të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale.
- **propozoj** ide dhe procese **të reja** në fushë.

Mund të krijoj aplikacione ose platforma të reja për shfletimin, kërkimin dhe filtrimin e portaleve dhe ofertave të punës, sipas nevojave të punëkërkuesve.



Nivelet e aftësisë

**Shembuj të përdorimit**

02 Skenari i mësimit:

Përgatitja e një raporti të shkurtër për një temë specifike

## Bazë

### 1

Në nivel bazë dhe me udhëzime, unë mund të:

- **identifikoj** nevojat e mia për informacion,
- **gjej** të dhëna, informacione dhe përmbajtje përmes kërkimit të thjeshtë në mjedise digjitale,
- **gjej** se si të qasem në këto të dhëna, informacione dhe përmbajtje dhe të navigoj ndërmjet tyre.
- **identifikoj** strategji **të thjeshta** personale të kërkimit.

Me ndihmë nga mësimdhënësja:

Mund të identifikoj sajtet e uebit, bloget dhe bazat e të dhënave nga një listë në tekstet e mia shkollore digjitale për të kërkuar për literaturë lidhur me temën e raportit.

Mund të identifikoj literaturën për temën e raportit në këto sajte të uebit, bloge dhe baza digjitale të të dhënave, dhe të qasem dhe të navigoj ndërmjet tyre.

Duke përdorur një listë të fjalëve kyçe të përgjithshme dhe të etiketave të disponueshme në tekstin tim shkollor digjital, mund të identifikoj ato që mund të jenë të dobishme për gjetjen e literaturës për temën e raportit




### 2

Në nivel bazë dhe i pavarur dhe me udhëzime të duhura kur është e nevojshme, unë mund të:

- **identifikoj** nevojat e mia për informacion,
- **gjej** të dhëna, informacione dhe përmbajtje përmes kërkimit të thjeshtë në mjedise digjitale,
- **gjej** se si të qasem në këto të dhëna, informacione dhe përmbajtje dhe të navigoj ndërmjet tyre.
- **identifikoj** strategji të thjeshta personale të kërkimit.

Në klasë me mësimdhënësen time me të cilën mund të konsultohem sa herë që kam nevojë:

Mund të identifikoj sajtet e uebit, bloget dhe bazat e të dhënave nga një listë në tekstet e mia shkollore digjitale për të kërkuar për literaturë lidhur me temën e raportit.

Mund të identifikoj literaturën për temën e raportit në këto sajte të uebit, bloge dhe baza digjitale të të dhënave, dhe të qasem dhe të navigoj ndërmjet tyre.

Duke përdorur një listë të fjalëve kyçe të përgjithshme dhe të etiketave të disponueshme në tekstin tim shkollor digjital, mund të identifikoj ato që mund të jenë të dobishme për gjetjen e literaturës për temën e raportit.



## I ndërmjetëm

### 3

Në mënyrë të pavarur dhe duke zgjidhur probleme të drejtpërdrejta, unë mund të:

- **shpjegoj** nevojat e mia për informacion,
- **kryej** kërkime **të përkufizuara mirë dhe rutinore** për të gjetur të dhëna, informacione dhe përmbajtje në mjedise digjitale,
- **shpjegoj** se si mund të qasem në to dhe të navigoj ndërmjet tyre.
- **shpjegoj** strategji kërkimi personale **të përkufizuara mirë dhe rutinore.**

Vetë:

Mund t'ia emërtoj mësimdhënëses sajtet e uebit, bloget dhe bazat digjitale të të dhënave të cilave u qasem zakonisht në kompjuterin tim për të konsultuar literaturën për detyrën time të shtëpisë.

Mund të përdor gjithashtu fjalë kyçe të përkufizuara mirë për të gjetur burime të literaturës në sajte të uebit, bloge dhe baza digjitale të të dhënave, dhe të shpjegoj se si qasem dhe navigoj ndërmjet rezultateve që gjej.

Mund t'u shpjegoj shokëve të klasës ato fjalë kyçe dhe etiketa që përdor zakonisht për të gjetur literaturë në mjedise digjitale (bloge, sajte uebi, baza të të dhënave) për të kryer detyrat e shtëpisë.

Mund të rregulloj probleme si identifikimi i qasjes së sajtit të gabuar të uebit ose navigimi larg nga sajtet e uebit që përdor zakonisht.



### 4

Në mënyrë të pavarur, sipas nevojave të mia, dhe duke zgjidhur probleme të përkufizuara mirë dhe jorutinore, unë mund të:

- **ilustroj** nevojat për informacion,
- **organizoj** kërkime të të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes në mjediset digjitale,
- **përshkrua**j mënyrën e qasjes në këto të dhëna, informacione dhe përmbajtje dhe të navigoj ndërmjet tyre.
- **organizoj** strategji personale të kërkimit.

Mund t'u jap shokëve të klasës shembuj të sajteve të uebit, blogeve dhe bazave digjitale të të dhënave me të cilat konsultohem për të gjetur literaturë për temën e raportit tim.

Mund të organizoj strategjinë time të kërkimit për të gjetur këto sajte të uebit, bloge dhe baza digjitale të të dhënave që përmbajnë literaturë lidhur me temën time të raportit.

Mund t'i përshkruaj mësimdhënëses sime se si mund të qasem dhe të navigoj ndërmjet sajteve të uebit, blogeve dhe bazave digjitale të të dhënave për të gjetur literaturën e marrë përmes këtij kërkimi të organizuar.

Mund të organizoj, me letra ngjitëse digjitale dhe në linjë në tabletin tim, një listë të fjalëve kyçe dhe etiketave të dobishme për të gjetur literaturën lidhur me temën e raportit.

Mund t'i përgjigjem problemeve ndërsa jam duke i bërë këto aktivitete. Për shembull, mund të shtoj fjalë të reja kyçe dhe etiketa në strategjitë e mia personale nëse nuk i gjej burimet e duhura lidhur me temën e raportit.



## I përparuar

### 5

Përveç udhëzimit të të tjerëve, unë mund të:

- **përgjigjem** ndaj nevojave për informacione,
- **aplikoj** kërkimet për të përfituar të dhëna, informacione dhe përmbajtje në mjediset digjitale,
- **tregoj** mënyrën e qasjes në këto të dhëna, informacione dhe përmbajtje dhe të navigoj ndërmjet tyre.
- **propozoj** strategji personale të kërkimit.

Për ta përgatitur raportin, mund të qasem në sajte të uebit, bloge dhe baza digjitale të të dhënave për të gjetur literaturë lidhur me temën, duke përdorur mjedisin digjital, qoftë atë që përdor ose mjedise të reja (OS, aplikacionet, pajisjet).

Mund t'i tregoj një shoqes së klasës se si të gjejë në tabletin e saj sajte të uebit, bloge dhe baza digjitale të të dhënave që përmbajnë literaturën për raportin.

Mund t'i shpjegoj asaj se si të qaset dhe të navigojë ndërmjet këtyre burimeve digjitale për të gjetur literaturë për raportin e saj.

Mund t'i ofroj një shoqes këshillat e mia se si i gjej sajtet e uebit, bloget dhe bazat digjitale të të dhënave me literaturën që lidhet me raportin duke përdorur fjalë kyçe dhe etiketa.



### 6

Në nivel të përparuar, sipas nevojave të mia personale dhe të të tjerëve, dhe në kontekste komplekse, unë mund të:

- **vlerësoj** nevojat për informacione,
- **përshtat** strategjinë time të kërkimit për të gjetur të dhënat, informacionet dhe përmbajtjen **më të përshtatshme** në mjediset digjitale,
- **shpjegoj** mënyrën e qasjes te të dhënat, informacionet dhe përmbajtja **më e përshtatshme** dhe të navigoj ndërmjet tyre.
- ndryshoj strategjitë personale të kërkimit.

Mund të vlerësoj sajtet më të përshtatshme të uebit, bloget dhe bazat digjitale të të dhënave për të marrë literaturë sipas nevojave të mia dhe të atyre të një shoqes.

Mund të gjej sajte të uebit, bloge dhe baza digjitale të të dhënave të përshtatura për nevojat e mia dhe ato të një shoqes, dhe të bëj dallimin midis burimeve digjitale të përshtatshme dhe të papërshtatshme, informacioneve të reja ose të padëshiruara ndërsa qasem dhe navigoj ndërmjet tyre.

Mund t'i shpjegoj mësimdhënëses sime se si i bëj këto kërkime dhe i tejkaloj situatat e papritura që paraqiten në mjedisin digjital (p.sh. nevojën për një emër përdoruesi për t'u qasur në arkivat e bibliotekës digjitale) për të gjetur literaturë për shkrimin e raportit.

Mund të jap këshilla duke theksuar strategjinë time personale për gjetjen e literaturës më të përshtatshme në sajte të uebit, bloge dhe baza digjitale të të dhënave, duke përfshirë shembuj për mënyrën se si mund të tejkaloj situatat komplekse që paraqiten gjatë navigimit ndërmjet këtyre burimeve digjitale (p.sh. mosgjetja e literaturës së mjaftueshme, të dhënat e padëshiruara).




## Tejet i specializuar

### 7

Në nivel tejet të specializuar, unë mund të:

- **krijoj zgjidhje për probleme komplekse me përkufizim të kufizuar** që lidhen me shfletimin, kërkimin dhe filtrimin e të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale.
- **integroj** njohuritë e mia **për të kontribuuar në praktikën dhe njohuritë profesionale dhe të udhëzoj të tjerët** për shfletim, kërkim dhe filtrim të të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale.

Mund të krijoj një platformë digjitale bashkëpunuese (blog, wiki etj.) në mjedisin digjital të mësimit të shkollës, për të ndarë dhe filtruar literaturën që më është dukur e dobishme për temën e raportit, duke udhëzuar shokët e klasës për shkrimin e raportit.




### 8

Në nivelin më të përparuar dhe të specializuar, unë mund të:

- **krijoj zgjidhje për të zgjidhur probleme komplekse me shumë faktorë ndërveprues** që lidhen me shfletimin, kërkimin dhe filtrimin e të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale.
- **propozoj** ide dhe procese **të reja** në fushë.

Mund të zhvilloj një aplikacion ose platformë të re për shfletimin, kërkimin dhe filtrimin e literaturës për tema akademike që do të përdoren nga klasa.



Seksioni 3

# Kompetencat

Ky seksion prezanton secilën kompetencë të DigComp 2.1 në një tabelë me katër dimensione: dimensioni 1 (fusha e kompetencës), dimensioni 2 (titulli i kompetencës dhe përshkruesi), dimensioni 3 (nivelet e aftësisë) dhe dimensioni 5 (shembuj të përdorimit). DigComp 2.1 nuk e përfshin dimensionin 4 (njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet).


## Fusha e kompetencës 1: Informacionet dhe njohja e të dhënave 23

1.1 Shfletimi, kërkimi dhe filtrimi i të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale
1.2 Vlerësimi i të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale
1.3 Menaxhimi i të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale

## Fusha e kompetencës 2: Komunikimi dhe bashkëpunimi 26

2.1 Ndërveprimi nëpërmjet teknologjive digjitale
2.2 Ndarja nëpërmjet teknologjive digjitale
2.3 Angazhimi në qytetari nëpërmjet teknologjive digjitale
2.4 Bashkëpunimi nëpërmjet teknologjive digjitale
2.5 Normat e komunikimit në internet
2.6 Menaxhimi i identitetit digjital

## Fusha e kompetencës 3: Krijimi i përmbajtjes digjitale 32

3.1 Zhvillimi i përmbajtjes digjitale
3.2 Integrimi dhe rielaborimi i përmbajtjes digjitale
3.3 Të drejtat e autorit dhe licencat
3.4 Programimi

## Fusha e kompetencës 4: Siguria 36

4.1 Mbrojtja e pajisjeve
4.2 Mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësisë
4.3 Mbrojtja e shëndetit dhe mirëqenies
4.4 Mbrojtja e mjedisit

## Fusha e kompetencës 5: Zgjidhja e problemeve 40

5.1 Zgjidhja e problemeve teknike
5.2 Identifikimi i nevojave dhe përgjigjeve teknologjike
5.3 Përdorimi kreativ i teknologjive digjitale
5.4 Identifikimi i mangësive në kompetencën digjitale

# Kompetencat

**Fusha e kompetencës 1: Informacionet dhe njohja e të dhënave 1.1 Shfletimi, kërkimi dhe filtrimi i të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale**

Për të artikuluar nevojat për informacione, për të kërkuar për të dhëna, informacione dhe përmbajtje në mjediset digjitale, për t'u qasur në to dhe për të naviguar midis tyre. Për të krijuar dhe përditësuar strategji personale të kërkimit

| Nivelet e aftësisë | Bazë 1 | Bazë 2 | I ndërmjetëm 3 | I ndërmjetëm 4 | I përparuar 5 | I përparuar 6 | Tejet i specializuar 7 | Tejet i specializuar 8 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Në nivel bazë dhe me udhëzime, unë mund të:<br>• **identifikoj** nevojat e mia për informacion,<br>• **gjej** të dhëna, informacione dhe përmbajtje përmes kërkimit të thjeshtë në mjedise digjitale,<br>• **gjej** se si të qasem në këto të dhëna, informacione dhe përmbajtje dhe të navigoj ndërmjet tyre.<br>• **identifikoj** strategji të thjeshta personale të kërkimit. | Në nivel bazë dhe i pavarur dhe me udhëzime të duhura kur është e nevojshme, unë mund të:<br>• **identifikoj** nevojat e mia për informacion,<br>• **gjej** të dhëna, informacione dhe përmbajtje kërkimit **të thjeshtë** në mjedise digjitale,<br>• **gjej** se si të qasem në këto të dhëna, informacione dhe përmbajtje dhe të navigoj ndërmjet tyre.<br>• **identifikoj** strategji **të thjeshta** personale të kërkimit. | Në mënyrë të pavarur dhe duke zgjidhur probleme të drejtpërdrejta, unë mund të:<br>• **shpjegoj** nevojat e mia për informacion,<br>• **kryej** kërkime **të përkufizuara mirë dhe rutinore** për të gjetur të dhëna, informacione dhe përmbajtje në mjedise digjitale,<br>• **shpjegoj** se si mund të qasem në to dhe të navigoj ndërmjet tyre.<br>• **shpjegoj** strategji kërkimi **personale të përkufizuara mirë dhe rutinore.** | Në mënyrë të pavarur, sipas nevojave të mia, dhe duke zgjidhur probleme të përkufizuara mirë dhe jorutinore, unë mund të:<br>• **ilustroj** nevojat për informacion,<br>• **organizoj** kërkimet e të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes në mjediset digjitale,<br>• **përshkruaj** se si të qasem në këto të dhëna, informacione dhe përmbajtje dhe të navigoj ndërmjet tyre.<br>• **organizoj** strategji personale të kërkimit. | Përveç udhëzimit të të tjerëve, unë mund të:<br>• **përgjigjem** ndaj nevojave për informacione,<br>• **aplikoj** kërkime për të përfituar të dhëna, informacione dhe përmbajtje në mjediset digjitale,<br>• **tregoj** se si të qasem në këto të dhëna, informacione dhe përmbajtje dhe të navigoj ndërmjet tyre.<br>• **propozoj** strategji personale të kërkimit. | Në nivel të përparuar, sipas nevojave të mia personale dhe të të tjerëve, dhe në kontekste komplekse, unë mund të:<br>• **vlerësoj** nevojat për informacione,<br>• **përshtat** strategjinë time të kërkimit për të gjetur të dhënat, informacionet dhe përmbajtjen **më të përshtatshme** në mjediset digjitale,<br>• **shpjegoj** mënyrën e qasjes te të dhënat, informacionet dhe përmbajtja **më e përshtatshme** dhe të navigoj ndërmjet tyre.<br>• **ndryshoj** strategjitë personale të kërkimit. | Në nivel tejet të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për probleme komplekse me përkufizim të kufizuar** që lidhen me shfletimin, kërkimin dhe filtrimin e të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale.<br>• **integroj** njohuritë e mia **për të kontribuuar në praktikën dhe njohuritë profesionale dhe të udhëzoj të tjerët** për shfletim, kërkim dhe filtrim të të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale. | Në nivelin më të përparuar dhe të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për zgjidhjen e problemeve komplekse me shumë faktorë ndërveprues** që lidhen me shfletimin, kërkimin dhe filtrimin e të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale.<br>• **propozoj** ide dhe procese **të reja** në fushë. |
| **Shembuj të përdorimit**<br>01<br>Skenari i punësimit:<br>Procesi i kërkimit për punë | Me ndihmën e këshilltares së punësimit:<br>Mund të identifikoj, nga një listë, ato portale të vendeve të punës që mund të më ndihmojnë të kërkoj për një punë.<br>Po ashtu mund t'i gjej këto portale pune në dyqanin e aplikacioneve në telefonin tim të mençur dhe të qasem dhe të navigoj ndërmjet tyre.<br>Nga një listë e fjalëve kyçe të përgjithshme për kërkimin e vendeve të punës në dispozicion në një blog për vende pune, mund të identifikoj fjalët kyçe që janë të dobishme për mua. | | | | | | | |
| **Shembuj të përdorimit**<br>02<br>Skenari i mësimit:<br>Përgatitja e një raporti të shkurtër për një temë specifike | Me ndihmë nga mësimdhënësi:<br>Mund të identifikoj sajtet e uebit, bloget dhe bazat e të dhënave nga një listë në tekstet e mia shkollore digjitale për të kërkuar lidhur me temën e raportit.<br>Mund të identifikoj literaturën për temën e raportit në këto sajte të uebit, bloge dhe baza digjitale të të dhënave, dhe të qasem dhe të navigoj ndërmjet tyre.<br>Duke përdorur një listë të fjalëve kyçe të përgjithshme dhe të etiketave të disponueshme në tekstin tim shkollor digjital, mund të identifikoj ato që mund të jenë të dobishme për gjetjen e literaturës për temën e raportit. | | | | | | | |

# Fusha e kompetencës 1: Informacionet dhe njohja e të dhënave 1.2 Vlerësimi i të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale

Për të analizuar, krahasuar dhe vlerësuar në mënyrë kritike kredibilitetin dhe besueshmërinë e burimeve të të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale. Për të analizuar, interpretuar dhe vlerësuar në mënyrë kritike të dhënat, informacionet dhe përmbajtjen digjitale.

| Nivelet e aftësisë | Bazë | | I ndërmjetëm | | I përparuar | | Tejet i specializuar | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 |
| | Në nivel bazë dhe me udhëzime, unë mund të:<br>• **hetoj** kredibilitetin dhe besueshmërinë e burimeve të zakonshme të të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale. | Në nivel bazë dhe i pavarur dhe me udhëzime të duhura kur është e nevojshme, unë mund të:<br>• **hetoj** kredibilitetin dhe besueshmërinë e burimeve të zakonshme të të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale. | Në mënyrë të pavarur dhe duke zgjidhur probleme të drejtpërdrejta, unë mund të:<br>• **kryej** analizën, krahasimin dhe vlerësimin e kredibilitetit dhe besueshmërisë së burimeve **të përkufizuara mirë** të të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale.<br>• **kryej** analizën, interpretimin dhe vlerësimin e të dhënave të përkufizuara mirë, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale | Në mënyrë të pavarur, sipas nevojave të mia, dhe duke zgjidhur probleme të përkufizuara mirë dhe jorutinore, unë mund të:<br>• **kryej** analizën, krahasimin dhe vlerësimin e të dhënave **të përkufizuara mirë**, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale.<br>• **kryej** analizën, interpretimin dhe vlerësimin e të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale. | Përveç udhëzimit të të tjerëve, unë mund të:<br>• **kryej** një vlerësim të kredibilitetit dhe besueshmërisë së burimeve **të ndryshme** të të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale.<br>• **kryej** një vlerësim të të dhënave **të ndryshme**, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale. | Në nivel të përparuar, sipas nevojave të mia personale dhe të të tjerëve, dhe në kontekste komplekse, unë mund të:<br>• **vlerësoj** në mënyrë kritike kredibilitetin dhe besueshmërinë e burimeve të të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale.<br>• **vlerësoj** në mënyrë kritike të dhënat, informacionet dhe përmbajtjen digjitale. | Në nivel shumë të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për probleme komplekse me përkufizim të kufizuar** që lidhen me analizimin dhe vlerësimin e burimeve kredibile dhe të besueshme të të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale në mjediset digjitale.<br>• **integroj** njohuritë e mia **për të kontribuar në praktika dhe njohuri profesionale dhe për të udhëzuar të tjerët** për analizën dhe vlerësimin e kredibilitetit dhe besueshmërisë së të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale dhe burimeve të tyre. | Në nivelin më të përparuar dhe të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për zgjidhjen e problemeve komplekse me shumë faktorë ndërveprues** që lidhen me analizimin dhe vlerësimin e burimeve kredibile dhe të besueshme të të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale në mjediset digjitale.<br>• **propozoj** ide dhe procese të reja në fushë. |
| **Shembuj të përdorimit**<br>01<br>Skenari i punësimit:<br>Procesi i kërkimit për punë | Me ndihmën e këshilltares së punësimit:<br>mund të identifikoj një listë të portaleve dhe aplikacioneve të punës që një shoqe ka gjetur në një blog për punësimin, ato që përdoren zakonisht sepse kanë oferta kredibile dhe të besueshme të punës. | | | | | | | |
| **Shembuj të përdorimit**<br>02<br>Skenari i mësimit:<br>Përgatitja e një raporti të shkurtër për një temë specifike | Ndihmuar nga mësimdhënësja:<br>mund të identifikoj, nga një listë në tekstin tim shkollor të blogeve dhe bazave digjitale të të dhënave që përmbajnë literaturë të disponueshme, ato që përdoren zakonisht sepse janë kredibile dhe të besueshme. | | | | | | | |

## Fusha e kompetencës 1: Informacionet dhe njohja e të dhënave 1.3 Menaxhimi i të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale

Për të organizuar, ruajtur dhe rinxjerrë të dhënat, informacionet dhe përmbajtjen në mjedise digjitale. Për t' i organizuar dhe përpunuar ato në një mjedis të strukturuar.

| Nivelet e aftësisë | Bazë 1 | Bazë 2 | I ndërmjetëm 3 | I ndërmjetëm 4 | I përparuar 5 | I përparuar 6 | Tejet i specializuar 7 | Tejet i specializuar 8 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Në nivel bazë dhe me udhëzime, unë mund të:<br>• **identifikoj** se si të organizoj, ruaj dhe rinxjerr në mënyrë **të thjeshtë** të dhënat, informacionet dhe përmbajtjen në mjedise digjitale.<br>• **di** se ku t'i organizoj ato në mënyrë **të thjeshtë** në një mjedis të strukturuar. | Në nivel bazë dhe i pavarur dhe me udhëzime të duhura kur është e nevojshme, unë mund të:<br>• **identifikoj** se si të organizoj, ruaj dhe rinxjerr në mënyrë **të thjeshtë** të dhënat, informacionet dhe përmbajtjen në mjedise digjitale.<br>• **di** se ku t'i organizoj ato në mënyrë **të thjeshtë** në një mjedis të strukturuar. | Në mënyrë të pavarur dhe duke zgjidhur probleme të drejtpërdrejta, unë mund të:<br>• **përzgjedh** të dhëna, informacione dhe përmbajtje për të organizuar, ruajtur dhe rinxjerrë të dhënat, informacionet dhe përmbajtjen në mjedise digjitale.<br>• **organizoj** ato si zakonisht në një mjedis të strukturuar. | Në mënyrë të pavarur, sipas nevojave të mia, dhe duke zgjidhur probleme të përkufizuara mirë dhe jorutinore, unë mund të:<br>• **organizoj** informacionet, të dhënat dhe përmbajtjen që të ruhen dhe të rinxirren me lehtësi.<br>• **organizoj** informacionet, të dhënat dhe përmbajtjen në një mjedis të strukturuar. | Përveç udhëzimit të të tjerëve, unë mund të:<br>• **menaxhoj** informacionet, të dhënat dhe përmbajtjen për organizim, ruajtje dhe rinxjerrje më të lehtë.<br>• **organizoj** dhe përpunoj ato në një mjedis të strukturuar. | Në nivel të përparuar, sipas nevojave të mia personale dhe të të tjerëve, dhe në kontekste komplekse, unë mund të:<br>• **përshtat** menaxhimin e informacioneve, të dhënave dhe përmbajtjes për nxjerrjen dhe ruajtjen më të lehtë dhe **më të përshtatshme**.<br>• **përshtat** ato që të organizohen dhe të përpunohen në mjedis të strukturuar **më të përshtatshëm**. | Në nivel tejet të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për probleme komplekse me përkufizim të kufizuar** që lidhen me menaxhimin e të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes për organizimin, ruajtjen dhe rinxjerrjen e tyre në një mjedis digjital të strukturuar.<br>• **integroj** njohuritë e mia **për të kontribuar në praktika dhe njohuri profesionale dhe udhëzoj të tjerët** lidhur me menaxhimin e të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes digjitale në një mjedis digjital të strukturuar. | Në nivelin më të përparuar dhe të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për të zgjidhur probleme komplekse me shumë faktorë ndërveprues** që lidhen me menaxhimin e të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjes për organizimin, ruajtjen dhe rinxjerrjen e tyre në një mjedis digjital të strukturuar.<br>• **propozoj** ide dhe procese të reja në fushë. |
| **Shembuj të përdorimit**<br>01<br>Skenari i punësimit:<br>Procesi i kërkimit për punë | | Në shtëpi me motrën time të cilën e pyes sa herë që kam nevojë:<br>Mund të identifikoj se si dhe ku mund të organizoj dhe gjurmoj shpalljet për vende pune në një aplikacion për vende pune (p.sh. www.indeed.com) në telefonin tim të mençur për t'i rinxjerrë ato kur të më duhen gjatë kërkimit të punës. | | | | | | |
| **Shembuj të përdorimit**<br>02<br>Skenari i mësimit:<br>Përgatitja e një raport të shkurtër për një temë specifike | | Në klasë me mësimdhënësen time me të cilën mund të konsultohem sa herë që kam nevojë:<br>Mund të identifikoj një aplikacion në tabletin tim për të organizuar dhe për të ruajtur lidhjet për tek ato sajte të uebit, bloge dhe baza digjitale të të dhënave të lidhura me një temë të caktuar të literaturës dhe ta përdor për t'i rinxjerrë ato kur të më duhen për raportin tim. | | | | | | |

| Nivelet e aftësisë | Bazë | | I ndërmjetëm | | I përparuar | | Tejet i specializuar | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 |
| | Në nivel bazë dhe me udhëzime, unë mund të:<br>• **përzgjedh** teknologji **të thjeshta** digjitale për të ndërvepruar, dhe<br>• **identifikoj** mjete **të thjeshta** të përshtatshme komunikimi për një kontekst të caktuar. | Në nivel bazë dhe i pavarur dhe me udhëzime të duhura kur është e nevojshme, unë mund të:<br>• **përzgjedh** teknologji **të thjeshta** digjitale për të ndërvepruar, dhe<br>• **identifikoj** mjete **të thjeshta** të përshtatshme komunikimi për një kontekst të caktuar. | Në mënyrë të pavarur dhe duke zgjidhur probleme të drejtpërdrejta, unë mund të:<br>• **kryej** ndërveprime **të përkufizuara mirë dhe rutinore** me teknologji digjitale, dhe<br>• **përzgjedh** mjete digjitale komunikimi **të përkufizuara mirë dhe rutinore** të përshtatshme për një kontekst të caktuar. | Në mënyrë të pavarur, sipas nevojave të mia, dhe duke zgjidhur probleme të përkufizuara mirë dhe jorutinore, unë mund të:<br>• **përzgjedh** një sërë teknologjish digjitale për të ndërvepruar, dhe<br>• **përzgjedh** një sërë mjetesh të komunikimit digjital **të përshtatshme** për një kontekst të caktuar. | Përveç udhëzimit të të tjerëve, unë mund të:<br>• **përdor** një sërë teknologjish digjitale për të ndërvepruar,<br>• **t'u tregoj** të tjerëve mjetet digjitale të komunikimit **më të përshtatshmet** për një kontekst të caktuar | Në nivel të përparuar, sipas nevojave të mia personale dhe të të tjerëve, dhe në kontekste komplekse, unë mund të:<br>• **përshtat** një sërë teknologjish digjitale për ndërveprimin **më të përshtatshëm**, dhe<br>• **përshtat** mjetet **më të përshtatshme** të komunikimit për një kontekst të caktuar. | Në nivel shumë të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për probleme komplekse me përkufizim të kufizuar** që lidhen me ndërveprimin përmes teknologjive digjitale dhe mjeteve të komunikimit digjital.<br>• **integroj** njohuritë e mia **për të kontribuar në praktika dhe njohuri profesionale dhe udhëzoj të tjerët** lidhur me ndërveprimin përmes teknologjive digjitale. | Në nivelin më të përparuar dhe të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për të zgjidhur probleme komplekse me shumë faktorë ndërveprues** që lidhen me ndërveprimin përmes teknologjive digjitale dhe mjeteve të komunikimit digjital<br>• **propozoj** ide dhe procese **të reja** në fushë. |
| **Shembuj të përdorimit**<br>01<br>Skenari i punësimit:<br>Organizimi i një ngjarjeje | | | Vetë:<br>Mund të ndërveproj me pjesëmarrësit dhe kolegët e tjerë duke përdorur aplikacionin për email të korporatës në telefonin tim të mençur për të organizuar një ngjarje për kompaninë time.<br>Mund të zgjedh gjithashtu opsione në dispozicion në emailin tim për të organizuar ngjarjen, si dërgimi i ftesave të kalendarit.<br>Mund të rregulloj probleme, p.sh. adresat e pasakta të emailit. | | | | | |
| **Shembuj të përdorimit**<br>02<br>Skenari i mësimit:<br>Përgatitja e punës në grup me shokët e klasës | | | Vetë:<br>Mund të përdor biseda që përdor zakonisht në telefonin tim të mençur (p.sh. Messenger në Facebook ose WhatsApp) për të biseduar me shokët e klasës dhe për të organizuar punën në grup.<br>Mund të zgjedh mjete të tjera digjitale të komunikimit në tabletin e klasës (p.sh. forumi i klasës sime) që mund të jenë të dobishme për të biseduar për detajet e organizimit të punës në grup.<br>Mund të rregulloj problemet si shtimi ose fshirja e anëtarëve në grupin e bisedës. | | | | | |

Fusha e kompetencës 2: Komunikimi dhe bashkëpunimi 2.2 Ndarja nëpërmjet teknologjive digjitale

Për të ndarë të dhëna, informacione dhe përmbajtje digjitale me të tjerët përmes teknologjive të duhura digjitale. Për të vepruar si një ndërmjetës, për të mësuar për praktikat e referencimit dhe atribuimit.

Nivelet e aftësisë

## Bazë

### 1

Në nivel bazë dhe me udhëzime, unë mund të:

- **njoh** teknologjitë digjitale **të thjeshta** të përshtatshme për të ndarë të dhënat, informacionet dhe përmbajtjen digjitale.
- **identifikoj** praktikat **e thjeshta** të referencimit dhe atribuimit.

### 2

Në nivel bazë dhe i pavarur dhe me udhëzime të duhura kur është e nevojshme, unë mund të:

- **njoh** teknologjitë digjitale **të thjeshta** të përshtatshme për të ndarë të dhënat, informacionet dhe përmbajtjen digjitale.
- **identifikoj** praktikat **e thjeshta** të referencimit dhe atribuimit.

## I ndërmjetëm

### 3

Në mënyrë të pavarur dhe duke zgjidhur probleme të drejtpërdrejta, unë mund të:

- **përzgjedh** teknologji digjitale **të përshtatshme të përkufizuara mirë** dhe rutinore për të ndarë të dhënat, informacionet dhe përmbajtjen digjitale.
- **shpjegoj** se si veprohet si një ndërmjetës për ndarjen e informacioneve dhe përmbajtjes përmes teknologjive digjitale **të përkufizuara mirë dhe rutinore**.
- **ilustroj** praktikat **e përkufizuara mirë dhe rutinore** të referencimit dhe atribuimit.

### 4

Në mënyrë të pavarur, sipas nevojave të mia, dhe duke zgjidhur problemet e përkufizuara mirë dhe jorutinore, unë mund të:

- **menaxhoj** teknologjitë e përshtatshme digjitale për të ndarë të dhënat, informacionet dhe përmbajtjen digjitale.
- **shpjegoj** se si veprohet si një ndërmjetës për ndarjen e informacioneve dhe përmbajtjes përmes teknologjive digjitale
- **ilustroj** praktikat e referencimit dhe atribuimit.

## I përparuar

### 5

Përveç udhëzimit të të tjerëve, unë mund të:

- **ndaj** të dhënat, informacionet dhe përmbajtjen digjitale përmes një **sërë** mjetesh të përshtatshme digjitale,
- **t'u tregoj** të tjerëve se si të veprojnë si një ndërmjetës për ndarjen e informacioneve dhe përmbajtjes përmes teknologjive digjitale.
- **aplikoj një sërë** praktikash referencimi dhe atribuimi.

### 6

Në nivel të përparuar, sipas nevojave të mia personale dhe të të tjerëve, dhe në kontekste komplekse, unë mund të:

- **vlerësoj** teknologjitë digjitale **më të përshtatshme** për të ndarë informacione dhe përmbajtje.
- **përshtat** rolin tim të ndërmjetësimit,
- **ndryshoj** përdorimin e praktikave **më të përshtatshme** të referencimit dhe atribuimit.

## Tejet i specializuar

### 7

Në nivel tejet të specializuar, unë mund të:

- **krijoj zgjidhje për probleme komplekse me përkufizim të kufizuar** që lidhen me ndarjen përmes teknologjive digjitale.
- **integroj** njohuritë e mia **për të kontribuar në praktika dhe njohuri profesionale dhe udhëzoj të tjerët** lidhur me ndarjen përmes teknologjive digjitale.

### 8

Në nivelin më të përparuar dhe të specializuar, unë mund të:

- **krijoj zgjidhje për zgjidhjen e problemeve komplekse me shumë faktorë ndërveprues** që lidhen me ndarjen përmes teknologjive digjitale.
- **propozoj** ide dhe procese **të reja** në fushë.

## Shembuj të përdorimit

01 Skenari i punësimit: Organizimi i një ngjarjeje

(Niveli 4)

Mund të përdor sistemin e arkivimit digjital të kompanisë për të ndarë agjendën e ngjarjes me listën e pjesëmarrësve që kam krijuar në kompjuterin tim.

Mund t'u tregoj kolegëve të mi në telefonat e tyre të mençur se si të qasen dhe të ndajnë agjendën duke përdorur sistemin e arkivimit digjital të organizatës sime.

Mund t'i tregoj shefes sime shembuj në tabletin e saj për burimet që përdor për të dizajnuar agjendën e ngjarjes.

Mund t'i përgjigjem çdo sfide derisa jam duke i kryer këto aktivitete, si problemet e papritura me ndarjen e agjendës me pjesëmarrësit.

## Shembuj të përdorimit

02 Skenari i mësimit: Përgatitja e punës në grup me shokët e klasës

(Niveli 4)

Mund të përdor një sistem arkivimi të bazuar në re kompjuterike (p.sh. Dropbox, Google Drive) për të ndarë materialin me anëtarët e tjerë të grupit tim.

Mund t'u shpjegoj anëtarëve të tjerë të grupit tim, duke përdorur laptopin e klasës, se si e ndaj materialin në sistemin e arkivimit digjital.

Mund t'i tregoj mësimdhënëses sime, në tabletin e saj, burimet digjitale që përdor për të përgatitur materialin për punën në grup.

Ndërsa kryej këto aktivitete, mund të zgjedh çdo problem që mund të paraqitet si zgjidhja e problemeve që lidhet me arkivimin dhe ndarjen e materialit me anëtarët e tjerë të grupit tim.

## Fusha e kompetencës 2: Komunikimi dhe bashkëpunimi | 2.3 Angazhimi në qytetari nëpërmjet teknologjive digjitale

Për të marrë pjesë në shoqëri përmes përdorimit të shërbimeve digjitale publike dhe private. Për të kërkuar mundësi për vetë-përmirësim dhe për qytetari pjesëmarrëse përmes teknologjive të duhura digjitale.

| Nivelet e aftësisë | Bazë 1 | Bazë 2 | I ndërmjetëm 3 | I ndërmjetëm 4 | I përparuar 5 | I përparuar 6 | Tejet i specializuar 7 | Tejet i specializuar 8 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Në nivel bazë dhe me udhëzime, unë mund të:<br>• **identifikoj** shërbimet **e thjeshta** digjitale për të marrë pjesë në shoqëri.<br>• mund të **njoh** teknologji digjitale **të thjeshta** dhe të përshtatshme për të fuqizuar veten dhe për të marrë pjesë në shoqëri si një qytetar. | Në nivel bazë dhe i pavarur dhe me udhëzime të duhura kur është e nevojshme, unë mund të:<br>• **identifikoj** shërbimet **e thjeshta** digjitale për të marrë pjesë në shoqëri.<br>• mund të **njoh** teknologji digjitale **të thjeshta** dhe të përshtatshme për të fuqizuar veten dhe për të marrë pjesë në shoqëri si një qytetar. | Në mënyrë të pavarur dhe duke zgjidhur probleme të drejtpërdrejta, unë mund të:<br>• **përzgjedh** shërbimet digjitale **të përkufizuara mirë dhe rutinore** për të marr pjesë në shoqëri.<br>• **dëftoj** teknologji digjitale **të përkufizuara mirë dhe rutinore** të përshtatshme për të fuqizuar veten dhe për të marrë pjesë në shoqëri si një qytetar. | Në mënyrë të pavarur, sipas nevojave të mia, dhe duke zgjidhur probleme të përkufizuara mirë dhe jorutinore, unë mund të:<br>• **përzgjedh** shërbimet digjitale për të marrë pjesë në shoqëri.<br>• **diskutoj** teknologjitë digjitale të përshtatshme për të fuqizuar veten dhe për të marrë pjesë në shoqëri si një qytetar. | Përveç udhëzimit të të tjerëve, unë mund të:<br>• **propozoj** shërbime **të ndryshme** digjitale për të marrë pjesë në shoqëri.<br>• **përdor** teknologji digjitale të përshtatshme për të fuqizuar veten dhe për të marrë pjesë në shoqëri si një qytetar. | Në nivel të përparuar, sipas nevojave të mia personale dhe të të tjerëve, dhe në kontekste komplekse, unë mund të:<br>• **ndryshoj** përdorimin e shërbimeve **më të përshtatshme** digjitale për të marrë pjesë në shoqëri.<br>• **ndryshoj** përdorimin e teknologjive **më të përshtatshme** digjitale për të fuqizuar veten dhe për të marrë pjesë në shoqëri si një qytetar. | Në nivel tejet të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për probleme komplekse me përkufizim të kufizuar** që lidhen me angazhimin në qytetari nëpërmjet teknologjive digjitale.<br>• **integroj** njohuritë e mia **për të kontribuar në praktika dhe njohuri profesionale dhe udhëzoj të tjerët** lidhur me angazhimin në qytetari nëpërmjet teknologjive digjitale. | Në nivelin më të përparuar dhe të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për të zgjidhur probleme me shumë faktorë ndërveprues** që lidhen me angazhimin në qytetari nëpërmjet teknologjive digjitale.<br>• **propozoj** ide dhe procese **të reja** në fushë. |
| **Shembuj të përdorimit**<br>01<br>Skenari i punësimit:<br>Organizimi i një ngjarjeje | | | | | Mund të propozoj dhe përdor strategji të ndryshme të medias (p.sh. anketë në FaceBook, Hastags në Instagram dhe Twitter) për të fuqizuar qytetarët e qytetit tim për të marrë pjesë në përkufizimin e temave kryesore të një ngjarjeje lidhur me përdorimin e sheqerit në prodhimin e ushqimit.<br><br>Mund të informoj kolegët e mi për këto strategji dhe t'u tregoj atyre se si të përdorin një strategji të caktuar për të fuqizuar qytetarët që të marrin pjesë. | | | |
| **Shembuj të përdorimit**<br>02<br>Skenari i mësimit:<br>Përgatitja e punës në grup me shokët e klasës | | | | | Mund të propozoj dhe përdor mikro bloge të ndryshme (p.sh. Twitter), bloge dhe *wikis*, për një konsultim publik lidhur me përfshirjen sociale të emigrantëve në lagjen time për të mbledhur propozime për temën e punës në grup.<br><br>Mund të informoj shokët e klasës për këto platforma digjitale dhe t'i udhëzoj se si të përdorin një të veçantë për të fuqizuar pjesëmarrjen qytetare në lagjen e tyre. | | | |

## Nivelet e aftësisë

### Bazë

**1**

Në nivel bazë dhe me udhëzime, unë mund të:

- **zgjedh** mjete dhe teknologji digjitale **të thjeshta** për procese bashkëpunuese.

**2**

Në nivel bazë dhe i pavarur dhe me udhëzime të duhura kur është e nevojshme, unë mund të:

- **zgjedh** mjete dhe teknologji digjitale **të thjeshta** për procese bashkëpunuese.

### I ndërmjetëm

**3**

Në mënyrë të pavarur dhe duke zgjidhur probleme të drejtpërdrejta, unë mund të:

- **përzgjedh** mjete dhe teknologji digjitale **të përkufizuara mirë dhe rutinore** për procese bashkëpunuese.

**4**

Në mënyrë të pavarur, sipas nevojave të mia, dhe duke zgjidhur probleme të përkufizuara mirë dhe jorutinore, unë mund të:

- **përzgjedh** mjete dhe teknologji digjitale për procese bashkëpunuese.

### I përparuar

**5**

Përveç udhëzimit të të tjerëve, unë mund të:

- **propozoj** mjete dhe teknologji të ndryshme digjitale për procese bashkëpunuese.

**6**

Në nivel të përparuar, sipas nevojave të mia personale dhe të të tjerëve, dhe në kontekste komplekse, unë mund të:

- **ndryshoj** përdorimin e mjeteve dhe teknologjive digjitale **më të përshtatshme** për procese bashkëpunuese.
- **zgjedh** mjetet dhe teknologjitë **më të përshtatshme** digjitale për rindërtimin dhe bashkë-krijimin e të dhënave, burimeve dhe njohurive.

### Tejet i specializuar

**7**

Në nivel tejet të specializuar, unë mund të:

- **krijoj zgjidhje për probleme komplekse me përkufizim të kufizuar** që lidhen me përdorimin e proceseve bashkëpunuese dhe bashkë-ndërtimin dhe bashkë-krijimin e të dhënave, burimeve dhe njohurive përmes mjeteve dhe teknologjive digjitale.
- **integroj** njohuritë e mia **për të kontribuar në praktika dhe njohuri profesionale dhe udhëzoj të tjerët** lidhur me bashkëpunimin përmes teknologjive digjitale.

**8**

Në nivelin më të përparuar dhe të specializuar, unë mund të:

- **krijoj zgjidhje për të zgjidhur probleme komplekse me shumë faktorë ndërveprues** që lidhen me përdorimin e proceseve bashkëpunuese dhe bashkë-ndërtimin dhe bashkë-krijimin e të dhënave. burimeve dhe njohurive përmes mjeteve dhe teknologjive digjitale.
- **propozoj** ide dhe procese **të reja** në fushë.

## Shembuj të përdorimit

**01**

**Skenari i punësimit: Organizimi i një ngjarjeje**

(Niveli 6)

Mund të përdor mjetet më të përshtatshme digjitale në punë (p.sh. Dropbox, Google Drive, wiki) për të krijuar me kolegët e mi një fletëpalosje dhe një blog për ngjarjen.

Mund të bëj dallimin midis mjeteve digjitale të përshtatshme dhe të papërshtatshme për proceset bashkëpunuese. Të papërshtatshme janë ato mjete që nuk e adresojnë qëllimin dhe fushëveprimin e detyrës - p.sh. redaktimi i një teksti njëkohësisht nga dy persona në një *wiki* është jopraktik.

Mund të tejkaloj situata të papritura që mund të paraqiten në mjedise digjitale gjatë bashkë-krijimit të fletëpalosjes dhe blogut (p.sh. kontrollimi i qasjes për të redaktuar dokumente ose rastet kur një kolege nuk mund të ruaj ndryshimet në material).

## Shembuj të përdorimit

**02**

**Skenari i mësimit: Përgatitja e punës në grup me shokët e klasës**

(Niveli 6)

Mund të përdor burimet më të përshtatshme digjitale për të krijuar një video lidhur me punën në tabletin tim me shokët e mi të klasës. Mund të bëj dallimin midis burimeve digjitale të përshtatshme dhe të papërshtatshme për të krijuar një video dhe për të punuar në një mjedis digjital së bashku me shokët e tjerë të klasës.

Mund të tejkaloj situatat e papritura që paraqiten në mjedisin digjital gjatë bashkë-krijimit të të dhënave dhe përmbajtjes dhe realizimit të një videoje gjatë punës në grup (p.sh. një skedar nuk përditësohet me ndryshimet e bëra nga anëtarët, një anëtar nuk di se si të ngarkoj një skedar në mjetin digjital).

| Nivelet e aftësisë | Bazë 1 | Bazë 2 | I ndërmjetëm 3 | I ndërmjetëm 4 | I përparuar 5 | I përparuar 6 | Tejet i specializuar 7 | Tejet i specializuar 8 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Në nivel bazë dhe me udhëzime, unë mund të:<br>• **dalloj** normat **e thjeshta** të sjelljes dhe njohuritë teknike gjatë përdorimit të teknologjive digjitale dhe ndërveprimit në mjedise digjitale.<br>• **zgjedh** mënyrat dhe strategjitë e **thjeshta** të përshtatura për një audiencë dhe<br>• **dalloj** aspektet **e thjeshta** të diversitetit kulturor dhe ndërmjet brezave që duhen marrë parasysh në mjediset digjitale. | Në nivel bazë dhe i pavarur dhe me udhëzime të duhura kur është e nevojshme, unë mund të:<br>• **dalloj** normat **e thjeshta** të sjelljes dhe njohuritë teknike gjatë përdorimit të teknologjive digjitale dhe ndërveprimit në mjedise digjitale.<br>• **zgjedh** mënyrat dhe strategjitë **e thjeshta** të komunikimit të përshtatura për një audiencë dhe<br>• **dalloj** aspektet **e thjeshta** të diversitetit kulturor dhe ndërmjet brezave që duhen marrë parasysh në mjediset digjitale. | Në mënyrë të pavarur dhe duke zgjidhur probleme të drejtpërdrejta, unë mund të:<br>• **sqaroj** norma **rutinore dhe të përkufizuara mirë** të sjelljes dhe njohuritë teknike gjatë përdorimit të teknologjive digjitale dhe ndërveprimit në mjedise digjitale.<br>• **shpreh** strategjitë **e përkufizuara mirë dhe rutinore** të komunikimit të përshtatura për një audiencë dhe<br>• **përshkruaj** aspektet e **përkufizuara mirë dhe rutinore** të diversitetit kulturor dhe ndërmjet brezave që duhen marrë parasysh në mjediset digjitale. | Në mënyrë të pavarur, sipas nevojave të mia, dhe duke zgjidhur probleme të përkufizuara mirë dhe jorutinore, unë mund të:<br>• **diskutoj** normat e sjelljes dhe njohuritë teknike gjatë përdorimit të teknologjive digjitale dhe ndërveprimit në mjedise digjitale.<br>• **diskutoj** strategjitë e komunikimit të përshtatura për një audiencë dhe<br>• **diskutoj** aspektet e diversitetit kulturor dhe ndërmjet brezave që duhen marrë parasysh në mjediset digjitale. | Përveç udhëzimit të të tjerëve, unë mund të:<br>• **aplikoj** normat **e ndryshme** të sjelljes dhe njohuritë teknike gjatë përdorimit të teknologjive digjitale dhe ndërveprimit në mjedise digjitale.<br>• **aplikoj** strategji **të ndryshme** të komunikimit në mjediset digjitale të përshtatura për një audiencë dhe<br>• **aplikoj** aspektet **e ndryshme** të diversitetit kulturor dhe ndërmjet brezave që duhen marrë parasysh në mjediset digjitale. | Në nivel të përparuar, sipas nevojave të mia personale dhe të të tjerëve, dhe në kontekste komplekse, unë mund të:<br>• **përshtat** normat **më të përshtatshme** të sjelljes dhe njohuritë teknike gjatë përdorimit të teknologjive digjitale dhe ndërveprimit në mjedise digjitale.<br>• **përshtat** strategjitë **më të përshtatshme** të komunikimit në mjedise digjitale për një audiencë dhe<br>• **aplikoj** aspekte **të ndryshme** të diversitetit kulturor dhe ndërmjet brezave në mjediset digjitale. | Në nivel tejet të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për probleme komplekse me përkufizim të kufizuar** që lidhen me etiketat digjitale të respektueshme ndaj audiencave të ndryshme dhe diversitetit kulturor dhe ndërmjet brezave.<br>• **integroj** njohuritë e mia **për të kontribuar në praktika dhe njohuri profesionale dhe udhëzoj të tjerët** lidhur me etiketën digjitale. | Në nivelin më të përparuar dhe të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për të zgjidhur probleme komplekse me shumë faktorë ndërveprues** që lidhen me etiketat digjitale të respektueshme ndaj audiencave të ndryshme dhe diversitetit kulturor dhe ndërmjet brezave.<br>• **propozoj** ide dhe procese **të reja** në fushë. |
| **Shembuj të përdorimit**<br>01<br>Skenari i punësimit:<br>Organizimi i një ngjarjeje | | | | | | | Gjatë organizimit të një ngjarjeje për organizatën time, mund të zgjidh problemet që paraqiten gjatë shkrimit dhe komunikimit në mjedise digjitale (p.sh. komentet e papërshtatshme për organizatën time në një rrjet social).<br><br>Mund të krijoj rregulla nga kjo praktikë që kolegët e mi të tanishëm dhe të ardhshëm t'i zbatojnë dhe përdorin si udhëzim. | |
| **Shembuj të përdorimit**<br>02<br>Skenari i mësimit:<br>Përgatitja e punës në grup me shokët e klasës | | | | | | | Mund të zgjidh probleme të etiketës me shokët e klasës gjatë përdorimit të një platforme digjitale bashkëpunuese (blog, wiki, etj.) për punën në grup (p.sh. shokët e klasës që kritikojnë njëri-tjetrin).<br><br>Mund të krijoj rregulla për sjelljen e duhur gjatë punës në linjë si grup të cilat mund të përdoren dhe të ndahen në mjedisin e mësimit digjital të shkollës. Po ashtu mund t'i udhëzoj shokët e klasës lidhur me atë që përbën një sjellje digjitale të përshtatshme gjatë punës me të tjerët në një platformë digjitale. | |

**Fusha e kompetencës 2: Komunikimi dhe bashkëpunimi** 2.6 Menaxhimi i identitetit digjital

Për të krijuar dhe menaxhuar një ose disa identitete digjitale, për të qenë në gjendje për të mbrojtur reputacionin personal, për të menaxhuar të dhënat që dikush prodhon nëpërmjet disa mjeteve, mjediseve dhe shërbimeve digjitale.

| Nivelet e aftësisë | Bazë 1 | Bazë 2 | I ndërmjetëm 3 | I ndërmjetëm 4 | I përparuar 5 | I përparuar 6 | Tejet i specializuar 7 | Tejet i specializuar 8 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Në nivel bazë dhe me udhëzime, unë mund të:<br>• **identifikoj** një identitet digjital,<br>• **përshkruaj** mënyra **të thjeshta** për të mbrojtur reputacionin tim në linjë,<br>• **njoh** të dhënat **e thjeshta** që nxjerr përmes mjeteve, mjediseve ose shërbimeve digjitale. | Në nivel bazë dhe i pavarur dhe me udhëzime të duhura kur është e nevojshme, unë mund të:<br>• **identifikoj** një identitet digjital,<br>• **përshkruaj** mënyra **të thjeshta** për të mbrojtur reputacionin tim në linjë,<br>• **njoh** të dhënat **e thjeshta** që nxjerr përmes mjeteve, mjediseve ose shërbimeve digjitale. | Në mënyrë të pavarur dhe duke zgjidhur probleme të drejtpërdrejta, unë mund të:<br>• **dalloj** një sërë identitetesh digjitale **të përkufizuara mirë dhe rutinore**.<br>• **shpjegoj** mënyrat **e përkufizuara mirë dhe rutinore** për të mbrojtur reputacionin tim në linjë,<br>• **përshkruaj** të dhënat **e përkufizuara mirë** që nxjerr **në mënyrë rutinore** përmes mjeteve, mjediseve ose shërbimeve digjitale. | Në mënyrë të pavarur, sipas nevojave të mia, dhe duke zgjidhur probleme të përkufizuara mirë dhe jorutinore, unë mund të:<br>• **paraqes një sërë** identitetesh digjitale specifike,<br>• **diskutoj** mënyra **specifike** për të mbrojtur reputacionin tim në linjë,<br>• **menaxhoj** të dhënat që nxjerr përmes mjeteve, mjediseve ose shërbimeve digjitale. | Përveç udhëzimit të të tjerëve, unë mund të:<br>• **përdor një sërë** identitetesh digjitale,<br>• **aplikoj** mënyra **të ndryshme** për të mbrojtur reputacionin tim në linjë,<br>• **përdor** të dhënat që nxjerr përmes mjeteve, mjediseve ose shërbimeve digjitale. | Në nivel të përparuar, sipas nevojave të mia personale dhe të të tjerëve, dhe në kontekste komplekse, unë mund të:<br>• **dalloj** disa identitete digjitale,<br>• **shpjegoj** mënyrat më të përshtatshme për të mbrojtur reputacionin e dikujt,<br>• **ndryshoj** të dhënat e krijuara me disa mjete, mjedise dhe shërbime. | Në nivel tejet të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për probleme komplekse me përkufizim të kufizuar** që lidhen me menaxhimin e identiteteve digjitale dhe mbrojtjen e reputacionit në linjë të personave.<br>• **integroj** njohuritë e mia **për të kontribuuar në praktikën** dhe njohuritë **profesionale** dhe **të udhëzoj të tjerët** në menaxhimin e identitetit digjital. | Në nivelin më të përparuar dhe të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për të zgjidhur probleme komplekse me shumë faktorë ndërveprues** që lidhen me menaxhimin e identiteteve digjitale dhe mbrojtjen e reputacionit në linjë të personave.<br>• **propozoj** ide dhe procese **të reja** në fushë. |
| **Shembuj të përdorimit**<br>01<br>Skenari i punësimit:<br>Organizimi i një ngjarjeje | | | | | | | | Mund t'i propozoj shefes sime një procedurë të re të medias sociale që shmang veprimet që mund të dëmtojnë reputacionin digjital të kompanisë sonë (p.sh. emailet e padëshiruara ) gjatë promovimit të ngjarjeve të kompanisë. |
| **Shembuj të përdorimit**<br>02<br>Skenari i mësimit:<br>Përgatitja e punës në grup me shokët e klasës | | | | | | | | Mund të propozoj një procedurë të re për shkollën time që shmang publikimin e përmbajtjes digjitale (teksteve, imazheve, videove) që mund të dëmtojnë reputacionin e studentëve. |

| Nivelet e aftësisë | Bazë 1 | Bazë 2 | I ndërmjetëm 3 | I ndërmjetëm 4 | I përparuar 5 | I përparuar 6 | Tejet i specializuar 7 | Tejet i specializuar 8 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Në nivel bazë dhe me udhëzime, unë mund të:<br>• **identifikoj** mënyra për të krijuar dhe redaktuar përmbajtje **të thjeshta** në formate **të thjeshta**,<br>• **zgjedh** se si të shprehem përmes krijimit të mjeteve **të thjeshta** digjitale. | Në nivel bazë dhe i pavarur dhe me udhëzime të duhura kur është e nevojshme, unë mund të:<br>• **identifikoj** mënyra për të krijuar dhe redaktuar përmbajtje **të thjeshta** në formate të thjeshta,<br>• **zgjedh** se si të shprehem përmes krijimit të mjeteve **të thjeshta** digjitale. | Në mënyrë të pavarur dhe duke zgjidhur probleme të drejtpërdrejta, unë mund të:<br>• **dëftoj** mënyra për të krijuar dhe redaktuar përmbajtje **të përkufizuara mirë dhe rutinore** në formate **të përkufizuara mirë dhe rutinore**,<br>• **shprehem** përmes krijimit të mjeteve digjitale **të përkufizuara mirë dhe rutinore**. | Në mënyrë të pavarur, sipas nevojave të mia, dhe duke zgjidhur probleme të përkufizuara mirë dhe jorutinore, unë mund të:<br>• **dëftoj** mënyra për të krijuar dhe redaktuar përmbajtjen në formate të ndryshme,<br>• **shprehem** përmes krijimit të mjeteve digjitale. | Përveç udhëzimit të të tjerëve, unë mund të:<br>• **aplikoj** mënyra për të krijuar dhe redaktuar përmbajtjen në formate të ndryshme,<br>• **tregoj** mënyra për t'u shprehur përmes krijimit të mjeteve digjitale. | Në nivel të përparuar, sipas nevojave të mia personale dhe të të tjerëve, dhe në kontekste komplekse, unë mund të:<br>• **ndryshoj** përmbajtjen duke përdorur formatet **më të përshtatshme**,<br>• **përshtat** të shprehurit përmes krijimit të mjeteve digjitale **më të përshtatshme**. | Në nivel tejet të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për probleme komplekse me përkufizim të kufizuar** që lidhen me krijimin dhe redaktimin e përmbajtjes në formate të ndryshme dhe shprehje të vetes përmes mjeteve digjitale.<br>• **integroj** njohuritë e mia **për të kontribuar në praktika dhe njohuri profesionale dhe udhëzoj të tjerët** në zhvillimin e përmbajtjes. | Në nivelin më të përparuar dhe të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për të zgjidhur probleme komplekse me shumë faktorë ndërveprues** që lidhen me krijimin dhe redaktimin e përmbajtjes në formate të ndryshme dhe shprehje të vetes përmes mjeteve digjitale.<br>• **propozoj** ide dhe procese **të reja** në fushë. |
| **Shembuj të përdorimit**<br>01<br>Skenari i punësimit:<br>Zhvillimi i një kursi të shkurtër (udhëzues) për të trajnuar personelin për një procedurë të re që do të aplikohet në organizatë | I ndihmuar nga një kolege që ka kompetencë digjitale të përparuar:<br>Mund të identifikoj, nga një video udhëzuese në YouTube, se si të krijoj një video të shkurtër të mbështetjes për t'ia prezantuar personelit në intranetin tonë procedurën e re organizative.<br>Nga një listë e përgatitur tashmë që një kolege e imja e ka gjetur në *wiki*, mund të identifikoj edhe mjete të tjera digjitale alternative për të krijuar procedurën për personelin. | | | | | | | |
| **Shembuj të përdorimit**<br>02<br>Skenari i mësimit:<br>Përgatitja e një prezantimi për një temë të caktuar që do ta bëj për shokët e klasës | I ndihmuar nga mësimdhënësja ime:<br>Mund të gjej se si të krijoj një prezantim digjital të animuar, duke përdorur udhëzuesin me video nga YouTube të ofruar nga mësimdhënësja ime për të më ndihmuar ta prezantoj punën time para shokëve të klasës.<br>Mund të identifikoj edhe mjete të tjera digjitale nga një artikull në tekstin tim shkollor që mund të më ndihmoj ta prezantoj punën si prezantim digjital i animuar para shokëve të klasës në dërrasën e bardhë digjitale ndërvepruese. | | | | | | | |

Fusha e kompetencës 3: Krijimi i përmbajtjes digjitale

## 3.2 Integrimi dhe ri-elaborimi i përmbajtjes digjitale

Për të modifikuar, përsosur, përmirësuar dhe integruar informacionin dhe përmbajtjen në një trupë ekzistuese të njohurive për të krijuar përmbajtje dhe njohuri të reja, origjinale dhe relevante.

| Nivelet e aftësisë | Bazë 1 | Bazë 2 | I ndërmjetëm 3 | I ndërmjetëm 4 | I përparuar 5 | I përparuar 6 | Tejet i specializuar 7 | Tejet i specializuar 8 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Në nivel bazë dhe me udhëzime, unë mund të:<br>• **përzgjedh** mënyra për të modifikuar, përsosur, përmirësuar dhe integruar njësi **të thjeshta** të përmbajtjes dhe informacioneve të reja për të krijuar përmbajtje të reja dhe origjinale. | Në nivel bazë dhe i pavarur dhe me udhëzime të duhura kur është e nevojshme, unë mund të:<br>• **përzgjedh** mënyra për të modifikuar, përsosur, përmirësuar dhe integruar njësi **të thjeshta** të përmbajtjes dhe informacioneve të reja për të krijuar përmbajtje të reja dhe origjinale | Në mënyrë të pavarur dhe duke zgjidhur probleme të drejtpërdrejta, unë mund të:<br>• **shpjegoj** mënyrat e modifikimit, përsosjes, përmirësimit dhe integrimit të njësive **të përkufizuara mirë** të përmbajtjes dhe informacioneve të reja për të krijuar përmbajtje të reja dhe origjinale. | Në mënyrë të pavarur, sipas nevojave të mia, dhe duke zgjidhur probleme të përkufizuara mirë dhe jorutinore, unë mund të:<br>• **diskutoj** mënyra për të modifikuar, përsosur, përmirësuar dhe integruar përmbajtje dhe informacione të reja për të krijuar përmbajtje të reja dhe origjinale. | Përveç udhëzimit të të tjerëve, unë mund të:<br>• **operoj** me njësi të reja **të ndryshme** të përmbajtjes dhe informacioneve, duke i modifikuar, përsosur, përmirësuar dhe integruar për të krijuar përmbajtje të reja dhe origjinale. | Në nivel të përparuar, sipas nevojave të mia personale dhe të të tjerëve, dhe në kontekste komplekse, unë mund të:<br>• **vlerësoj** mënyrat **më të përshtatshme** për të modifikuar, përsosur, përmirësuar dhe integruar njësi të reja të përmbajtjes dhe informacioneve për të krijuar përmbajtje të reja dhe origjinale. | Në nivel tejet të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për probleme komplekse me përkufizim të kufizuar** që lidhen me modifikimin, përsosjen, përmirësimin dhe integrimin e përmbajtjes dhe informacioneve të reja në krijuar përmbajtje të reja dhe origjinale.<br>• **integroj** njohuritë e mia **për të kontribuar në praktika dhe njohuri profesionale dhe udhëzoj të tjerët** në integrimin dhe ri-elaborimin e përmbajtjes | Në nivelin më të përparuar dhe të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për të zgjidhur probleme komplekse me shumë faktorë ndërveprues** që lidhen me modifikimin, përsosjen, përmirësimin dhe integrimin e përmbajtjes dhe informacioneve të reja në njohuritë ekzistuese për të krijuar përmbajtje të reja dhe origjinale.<br>• **propozoj** ide dhe procese **të reja** në fushë. |
| **Shembuj të përdorimit**<br>01<br>Skenari i punësimit:<br>Zhvillimi i një kursi të shkurtër (udhëzues) për të trajnuar personelin për një procedurë të re që do të aplikohet në organizatë | | Me ndihmën e një koleges (që ka kompetencë digjitale të përparuar dhe me të cilin mund të konsultohem sa herë që kam nevojë) dhe me ndihmën e një udhëzuesi me video me hapat që duhet të ndjek për ta realizuar:<br><br>mund të mësoj se si të shtoj dialog dhe imazhe të reja në një video të shkurtër mbështetëse tashmë të krijuar në intranet për të ilustruar procedurat e reja organizative. | | | | | | |
| **Shembuj të përdorimit**<br>02<br>Skenari i mësimit:<br>Përgatitja e një prezantimi për një temë të caktuar që do ta bëj për shokët e klasës | | Në shtëpi me nënën time (me të cilën mund të konsultohem sa herë që kam nevojë) dhe me ndihmën e një liste (të ruajtur në tabletin tim të ofruar nga mësimdhënësja ime me hapat që duhet të ndjek për ta realizuar):<br><br>mund të identifikoj se si të përditësoj një prezantim digjital të animuar që kam krijuar për ta prezantuar punën time para shokëve të klasës, duke shtuar tekstin, imazhet dhe efektet vizuale që do të shfaqen në klasë duke përdorur dërrasën e bardhë digjitale ndërvepruese. | | | | | | |

| Nivelet e aftësisë | 1 (Bazë) | 2 (Bazë) | 3 (I ndërmjetëm) | 4 (I ndërmjetëm) | 5 (I përparuar) | 6 (I përparuar) | 7 (Tejet i specializuar) | 8 (Tejet i specializuar) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Në nivel bazë dhe me udhëzime, unë mund të:<br>• **identifikoj** rregullat **e thjeshta** të të drejtave të autorit dhe licencave që aplikohen tek të dhënat, informacionet dhe përmbajtja digjitale. | Në nivel bazë dhe i pavarur dhe me udhëzime të duhura kur është e nevojshme, unë mund të:<br>• **identifikoj** rregullat **e thjeshta** të të drejtave të autorit dhe licencave që aplikohen tek të dhënat, informacionet dhe përmbajtja digjitale. | Në mënyrë të pavarur dhe duke zgjidhur probleme të drejtpërdrejta, unë mund të:<br>• **dëftoj** rregullat **e përkufizuara mirë dhe rutinore** të të drejtave të autorit dhe licencave që aplikohen tek të dhënat, informacionet dhe përmbajtja digjitale. | Në mënyrë të pavarur, sipas nevojave të mia, dhe duke zgjidhur probleme të përkufizuara mirë dhe jorutinore, unë mund të:<br>• **diskutoj** rregullat e të drejtave të autorit dhe licencave që aplikohen për informacione dhe përmbajtje digjitale. | Përveç udhëzimit të të tjerëve, unë mund të:<br>• **aplikoj** rregulla **të ndryshme** të të drejtave të autorit dhe licencave që aplikohen tek të dhënat, informacionet dhe përmbajtja digjitale. | Në nivel të përparuar, sipas nevojave të mia personale dhe të të tjerëve, dhe në kontekste komplekse, unë mund të:<br>• **zgjedh** rregullat **më të përshtatshme** që aplikohen për të drejtat e autorit dhe licencat për të dhënat, informacionet dhe përmbajtjen digjitale. | Në nivel tejet të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për probleme komplekse me përkufizim të kufizuar** që lidhen me aplikimin e të drejtave të autorit dhe licencave mbi të dhënat, informacionet dhe përmbajtjen digjitale.<br>• **integroj** njohuritë e mia për të kontribuar në praktikën dhe njohuritë profesionale dhe për t'i udhëzuar të tjerët për aplikimin e të drejtave të autorit dhe licencave. | Në nivelin më të përparuar dhe të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për të zgjidhur probleme komplekse me shumë faktorë ndërveprues** që lidhen me aplikimin e të drejtave të autorit dhe licencave mbi të dhënat, informacionet dhe përmbajtjen digjitale.<br>• **propozoj** ide dhe procese **të reja** në fushë. |
| **Shembuj të përdorimit**<br>01<br>Skenari i punësimit:<br>Zhvillimi i një kursi të shkurtër (udhëzues) për të trajnuar personelin për një procedurë të re që do të aplikohet në organizatë | | | Vetë:<br>mund t'i tregoj një koleges se cilat banka të imazheve i përdor zakonisht për të gjetur imazhe që mund t'i shkarkoj falas për një video udhëzuese të shkurtër për një procedurë të re për personelin e organizatës sime.<br>mund të merrem me probleme si identifikimi i simbolit që tregon nëse një imazh është i licencuar me një lloj të caktuar të licencës së Creative Commons dhe si rrjedhim mund të ripërdoret pa lejen e autorit. | | | | | |
| **Shembuj të përdorimit**<br>02<br>Skenari i mësimit:<br>Përgatitja e një prezantimi për një temë të caktuar që do ta bëj për shokët e klasës | | | Vetë:<br>mund t'i shpjegoj një shoqes se cilat banka të imazheve i përdor zakonisht për të gjetur imazhe që mund t'i shkarkosh tërësisht falas për të krijuar një animim digjital për ta prezantuar para shokëve të klasës.<br>mund të rregulloj probleme si identifikimi i simbolit që tregon se një imazh është i mbrojtur me të drejtën e autorit dhe si rrjedhim nuk mund të përdoret pa lejen e autorit. | | | | | |

| Nivelet e aftësisë | Bazë 1 | Bazë 2 | I ndërmjetëm 3 | I ndërmjetëm 4 | I përparuar 5 | I përparuar 6 | Tejet i specializuar 7 | Tejet i specializuar 8 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Në nivel bazë dhe me udhëzime, unë mund të:<br>• **listoj** udhëzime **të thjeshta** për një sistem informatik për të zgjidhur një problem të thjeshtë ose për të kryer një detyrë të thjeshtë. | Në nivel bazë dhe i pavarur dhe me udhëzime të duhura kur është e nevojshme, unë mund të:<br>• **listoj** udhëzime **të thjeshta** për një sistem informatik për të zgjidhur një problem të thjeshtë ose për të kryer një detyrë të thjeshtë. | Në mënyrë të pavarur dhe duke zgjidhur probleme të drejtpërdrejta, unë mund të:<br>• **listoj udhëzime të përkufizuara mirë dhe rutinore** për një sistem informatik për të zgjidhur probleme rutinore ose për të kryer detyra rutinore. | Në mënyrë të pavarur, sipas nevojave të mia, dhe duke zgjidhur probleme të përkufizuara mirë dhe jorutinore, unë mund të:<br>• **listoj** udhëzimet për një sistem informatik për të zgjidhur një problem të caktuar ose për të kryer një detyrë specifike. | Përveç udhëzimit të të tjerëve, unë mund të:<br>• **operoj** me udhëzime për një sistem informatik për të zgjidhur një problem të caktuar ose për të kryer detyra të ndryshme. | Në nivel të përparuar, sipas nevojave të mia personale dhe të të tjerëve, dhe në kontekste komplekse, unë mund të:<br>• **përcaktoj** udhëzimet **më të përshtatshme** për një sistem informatik për të zgjidhur një problem të caktuar ose për të kryer detyra specifike. | Në nivel tejet të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për probleme komplekse me një përkufizim të kufizuar** që lidhen me planifikimin dhe zhvillimin e udhëzimeve për një sistem informatik dhe kryerjen e një detyre përmes një sistemi informatik.<br>• **integroj** njohuritë e mia **për të kontribuar në praktikë dhe njohuri profesionale dhe për t'i udhëzuar të tjerët** për programim. | Në nivelin më të përparuar dhe të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për të zgjidhur probleme komplekse me shumë faktorë ndërveprues** që lidhen me planifikimin dhe zhvillimin e udhëzimeve për një sistem informatik dhe kryerjen e një detyre përmes një sistemi informatik.<br>• **propozoj** ide dhe procese **të reja** në fushë. |
| **Shembuj të përdorimit**<br>01<br>Skenari i punësimit:<br>Zhvillimi i një kursi të shkurtër (udhëzues) për të trajnuar personelin për një procedurë të re që do të aplikohet në organizatë | | | | Duke përdorur një gjuhë programuese (p.sh. Ruby, Python), mund të ofroj udhëzime për të zhvilluar një lojë edukative për të prezantuar procedurën e re që do të aplikohet në organizatë.<br>Mund të zgjidh probleme si korrigjimi i defekteve në kod në program për të rregulluar problemet me kodin. | | | | |
| **Shembuj të përdorimit**<br>02<br>Skenari i mësimit:<br>Përgatitja e një prezantimi për një temë të caktuar që do ta bëj për shokët e klasës | | | | Duke përdorur një ndërfaqe programimi grafike të thjeshtë (p.sh. Scratch Jr), mund të zhvilloj një aplikacion për telefona të mençur që ua prezanton punën time shokëve të klasës.<br>Nëse paraqitet një problem, e di se si ta korrigjoj defektin në program dhe mund të rregulloj problemet e lehta në kodin tim. | | | | |

**Fusha e kompetencës 4: Siguria** — **4.1 Mbrojtja e pajisjeve**

Për të mbrojtur pajisjet dhe përmbajtjen digjitale dhe për të kuptuar rreziqet dhe kërcënimet në mjediset digjitale. Për të ditur për mbrojtjen dhe masat e sigurisë dhe për të pasur konsideratën e duhur për besueshmërinë dhe privatësinë.

## Nivelet e aftësisë

### Bazë

**1**

Në nivel bazë dhe me udhëzime, unë mund të:

- **identifikoj** mënyra **të thjeshta** për të mbrojtur pajisjet e mia dhe përmbajtjen digjitale, dhe
- **dalloj** rreziqet dhe kërcënimet **e thjeshta** në mjediset digjitale,
- **zgjedh** masa **të thjeshta** sigurie dhe mbrojtjeje, dhe
- **identifikoj** mënyra **të thjeshta** për t'u kujdesur siç duhet për besueshmërinë dhe privatësinë

**2**

Në nivel bazë dhe i pavarur dhe me udhëzime të duhura kur është e nevojshme, unë mund të:

- **identifikoj** mënyra **të thjeshta** për të mbrojtur pajisjet e mia dhe përmbajtjen digjitale, dhe
- **dalloj** rreziqet dhe kërcënimet **e thjeshta** në mjediset digjitale,
- **ndjek** masa **të thjeshta** sigurie dhe mbrojtjeje.
- **identifikoj** mënyra **të thjeshta** për t'u kujdesur siç duhet për besueshmërinë dhe privatësinë

### I ndërmjetëm

**3**

Në mënyrë të pavarur dhe duke zgjidhur probleme të drejtpërdrejta, unë mund të:

- **dëftoj** mënyra **të përkufizuara mirë dhe rutinore** për të mbrojtur pajisjet e mia dhe përmbajtjen digjitale, dhe
- **dalloj** rreziqet dhe kërcënimet **e përkufizuara mirë dhe ato rutinore** në mjediset digjitale.
- **përzgjedh** masa sigurie dhe mbrojtjeje **të përkufizuara mirë dhe rutinore**.
- **dëftoj** mënyra **të përkufizuara mirë dhe rutinore** për t'u kujdesur siç duhet për besueshmërinë dhe privatësinë

**4**

Në mënyrë të pavarur, sipas nevojave të mia, dhe duke zgjidhur probleme të përkufizuara mirë dhe jorutinore, unë mund të:

- **organizoj** mënyra për të mbrojtur pajisjet e mia dhe përmbajtjen digjitale, dhe
- **dalloj** rreziqet dhe kërcënimet në mjediset digjitale,
- **përzgjedh** masa sigurie dhe mbrojtjeje.
- **shpjegoj** mënyrat për t'u kujdesur siç duhet për besueshmërinë dhe privatësinë

### I përparuar

**5**

Përveç udhëzimit të të tjerëve, unë mund të:

- **aplikoj** mënyra **të ndryshme** për të mbrojtur pajisjet e mia dhe përmbajtjen digjitale, dhe
- **dalloj një sërë** rreziqesh dhe kërcënimesh në mjediset digjitale,
- **aplikoj** masa sigurie dhe mbrojtjeje.
- **aplikoj** mënyra **të ndryshme** për t'u kujdesur siç duhet për besueshmërinë dhe privatësinë

**6**

Në nivel të përparuar, sipas nevojave të mia personale dhe të të tjerëve, dhe në kontekste komplekse, unë mund të:

- **zgjedh** mbrojtjen **më të përshtatshme** për pajisjet dhe përmbajtjen digjitale, dhe
- **dalloj** rreziqet dhe kërcënimet në mjediset digjitale,
- **zgjedh** masat **më të përshtatshme** të sigurisë dhe mbrojtjes.
- **vlerësoj** mënyrat **më të përshtatshme** për t'u kujdesur për besueshmërinë dhe privatësinë

### Tejet i specializuar

**7**

Në nivel tejet të specializuar, unë mund të:

- **krijoj zgjidhje për probleme komplekse me përkufizim të kufizuar** që lidhen me mbrojtjen e pajisjeve dhe përmbajtjes digjitale, menaxhimin e rreziqeve dhe kërcënimeve, aplikimin e masave të sigurisë dhe mbrojtjes, dhe besueshmërinë dhe privatësinë në mjediset digjitale.
- **integroj** njohuritë e mia **për të kontribuar në praktika dhe njohuri profesionale dhe udhëzoj të tjerët** në mbrojtjen e pajisjeve.

**8**

Në nivelin më të përparuar dhe të specializuar, unë mund të:

- **krijoj zgjidhje për të zgjidhur probleme komplekse me shumë faktorë ndërveprues** që lidhen me mbrojtjen e pajisjeve dhe përmbajtjes digjitale, menaxhimin e rreziqeve dhe kërcënimeve, aplikimin e masave të sigurisë dhe mbrojtjes, dhe besueshmërinë dhe privatësinë në mjediset digjitale.
- **propozoj** ide dhe procese **të reja** në fushë.

## Shembuj të përdorimit

**01 Skenari i punësimit:**

Përdorimi i një llogarie të Twitter për të ndarë informacionet e mia për organizatën time

*(Niveli 5)*

Mund të mbroj llogarinë e organizatës në Twitter duke përdorur metoda të ndryshme (p.sh. fjalëkalim të fuqishëm, kontroll të hyrjeve të fundit) dhe t'u tregoj kolegëve se si ta bëjnë këtë.

Mund të hetoj rreziqet si marrja e tweets dhe mesazheve nga ndjekës me profile false ose përpjekje për mashtrim (phishing).

Mund të aplikoj masa për t'i shmangur ato (p.sh. kontrollimi i parametrave të privatësisë).

Po ashtu mund të ndihmoj kolegët e mi për të hetuar rreziqet dhe kërcënimet gjatë përdorimit të Twitter.

## Shembuj të përdorimit

**02 Skenari i mësimit:**

Përdorimi i platformës së mësimit digjital të shkollës për të ndarë Informacion e për temat e interesit

*(Niveli 5)*

Mund të mbroj informacionet, të dhënat dhe përmbajtjen në platformën mësimore digjitale të shkollës (p.sh. fjalëkalimi i fuqishëm, kontrollimi i hyrjeve të fundit).

Mund të hetoj rreziqe dhe kërcënime të ndryshme gjatë qasjes në platformën digjitale të shkollës dhe të aplikoj masa për t'i shmangur ato (p.sh. se si të kontrollohen për viruse bashkëngjitjet para shkarkimit).

Mund t'i ndihmoj shokët e klasës për të hetuar rreziqet dhe kërcënimin gjatë përdorimit të platformës së mësimit digjital në tabletët e tyre (p.sh. kontrollimi se kush mund të qaset në skedarë).

# Fusha e kompetencës 4: Siguria 4.2 Mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësisë

Për të mbrojtur të dhënat personale dhe privatësinë në mjediset digjitale. Për të kuptuar se si përdoren dhe ndahen informacionet e identifikueshme në nivel personal duke qenë në gjendje të mbroni veten dhe të tjerët nga dëmtimet. Për të kuptuar se shërbimet digjitale përdorin një “Politikë të privatësisë” për informim rreth përdorimit të të dhënave personale.

Nivelet e aftësisë

## Bazë

### 1

Në nivel bazë dhe me udhëzime, unë mund të:

- **përzgjedh** mënyra **të thjeshta** për të mbrojtur të dhënat e mia personale dhe privatësinë në mjediset digjitale, dhe
- **identifikoj** mënyra **të thjeshta** për të përdorur dhe të ndarë informacionet e identifikueshme në nivel personal ndërsa mbroj veten dhe të tjerët nga dëmtimet.
- **identifikoj** deklarata **të thjeshta** të politikës së privatësisë se si të dhënat personale përdoren në shërbimet digjitale.

### 2

Në nivel bazë dhe i pavarur dhe me udhëzime të duhura kur është e nevojshme, unë mund të:

- **përzgjedh** mënyra **të thjeshta** për të mbrojtur të dhënat e mia personale dhe privatësinë në mjediset digjitale, dhe
- **identifikoj** mënyra **të thjeshta** për të përdorur dhe të ndarë informacionet e identifikueshme në nivel personal ndërsa mbroj veten dhe të tjerët nga dëmtimet.
- **identifikoj** deklarata **të thjeshta** të politikës së privatësisë se si të dhënat personale përdoren në shërbimet digjitale.

## I ndërmjetëm

### 3

Në mënyrë të pavarur dhe duke zgjidhur probleme të drejtpërdrejta, unë mund të:

- **shpjegoj** mënyra **të përkufizuara mirë dhe rutinore** për të mbrojtur të dhënat e mia personale dhe privatësinë në mjediset digjitale, dhe
- shpjegoj mënyra **të përkufizuara mirë dhe rutinore** për të përdorur dhe ndarë informacionet e identifikueshme në nivel personal ndërsa mbroj veten dhe të tjerët nga dëmtimet.
- **dëftoj** deklarata **të përkufizuara mirë dhe rutinore** të politikës së privatësisë se si të dhënat personale përdoren në shërbimet digjitale.

### 4

Në mënyrë të pavarur, sipas nevojave të mia, dhe duke zgjidhur probleme të përkufizuara mirë dhe jorutinore, unë mund të:

- **diskutoj** mënyra për të mbrojtur të dhënat e mia personale dhe privatësinë në mjediset digjitale, dhe
- **diskutoj** mënyra për të përdorur dhe për të ndarë informacionet e identifikueshme në nivel personal ndërsa mbroj veten dhe të tjerët nga dëmtimet.
- **dëftoj** deklarata të politikës së privatësisë se si të dhënat personale përdoren në shërbimet digjitale.

## I përparuar

### 5

Përveç udhëzimit të të tjerëve, unë mund të:

- **aplikoj** mënyra **të ndryshme** për të mbrojtur të dhënat e mia personale dhe privatësinë në mjediset digjitale, dhe
- **aplikoj** mënyra **të ndryshme** për të ndarë të dhënat e mia ndërsa mbroj veten dhe të tjerët nga dëmtimet.
- **shpjegoj** deklarata të politikës së privatësisë se si të dhënat personale përdoren në shërbimet digjitale.

### 6

Në nivel të përparuar, sipas nevojave të mia dhe të atyre të të tjerëve, dhe në kontekste komplekse, unë mund të:

- **zgjedh** mënyrat **më të përshtatshme** për të mbrojtur të dhënat personale dhe privatësinë në mjediset digjitale, dhe
- **vlerësoj** mënyrat **më të përshtatshme** për të përdorur dhe për të ndarë informacionet e identifikueshme në nivel personal ndërsa mbroj veten dhe të tjerët nga dëmtimet.
- **vlerësoj përshtatshmërinë** e deklaratave të politikës së privatësisë për mënyrën e përdorimit të të dhënave personale.

## Tejet i specializuar

### 7

Në nivel shumë të specializuar, unë mund të:

- **krijoj zgjidhje për probleme komplekse me përkufizim të kufizuar** që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë në mjediset digjitale, përdorimin dhe ndarjen e informacioneve të identifikueshme në nivel personal për ta mbrojtur veten dhe të tjerët nga rreziqet dhe politikat e privatësisë për përdorimin e të dhënave të mia personale.
- **integroj** njohuritë e mia **për të kontribuar në praktika dhe njohuri profesionale dhe udhëzoj të tjerët** në mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë.

### 8

Në nivelin më të përparuar dhe të specializuar, unë mund të:

- **krijoj zgjidhje për të zgjidhur probleme me shumë faktorë ndërveprues** që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë në mjediset digjitale, përdorimin dhe ndarjen e informacioneve të identifikueshme në nivel personal për ta mbrojtur veten dhe të tjerët nga rreziqet dhe politikat e privatësisë për përdorimin e të dhënave të mia personale.
- **propozoj** ide dhe procese **të reja** në fushë.

## Shembuj të përdorimit

01 Skenari i punësimit: Përdorimi i një llogarie të Twitter për të ndarë informacionet e mia për organizatën time

Unë mund të zgjedh mënyrën më të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale të kolegëve të mi (p.sh. adresën, numrin e telefonit) gjatë ndarjes së përmbajtjes digjitale (p.sh. një fotografie) në llogarinë e korporatës në Twitter.

Mund të bëj dallimin midis përmbajtjes së përshtatshme dhe të papërshtatshme digjitale për ta ndarë në llogarinë e korporatës në Twitter, në mënyrë që privatësia ime dhe e kolegëve të mi të mos dëmtohet.

Mund të vlerësoj nëse të dhënat personale janë përdorur në llogarinë e korporatës në Twitter sipas Ligjit evropian për mbrojtjen e të dhënave dhe Të drejtës për t'u harruar.

Mund të merrem me situata komplekse që mund të paraqiten lidhur me të dhënat personale në organizatën time gjatë kohës që jam në Twitter, si heqja e fotografive dhe emrave për të mbrojtur të dhënat personale në pajtim me Ligjin evropian për mbrojtjen e të dhënave dhe Të drejtën për t'u harruar.

## Shembuj të përdorimit

02 Skenari i mësimit: Përdorimi i platformës së mësimit digjital të shkollës për të ndarë informacione për temat e interesit

Mund të përzgjedh mënyrën më të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat e mia personale (p.sh. adresën, numrin e telefonit), para ndarjes së tyre në platformën digjitale të shkollës.

Mund të bëj dallimin midis përmbajtjes digjitale të përshtatshme dhe të papërshtatshme për ta ndarë në platformën digjitale të shkollës, në mënyrë që privatësia ime dhe e shokëve të mi të klasës të mos dëmtohet.

Mund të vlerësoj nëse mënyra se si të dhënat e mia janë përdorur në platformën digjitale është e duhura dhe e pranueshme për sa i përket të drejtave të mia dhe privatësisë sime.

Mund të tejkaloj situata komplekse që mund të paraqiten me të dhënat e mia personale dhe ato të shokëve të mi të klasës gjatë kohës që jam në platformën digjitale arsimore, si në rastet kur të dhënat personale nuk janë përdorur në pajtim me “Politikën e privatësisë” të platformës.

## Fusha e kompetencës 4: Siguria 4.3 Mbrojtja e shëndetit dhe mirëqenies

Për të qenë në gjendje të shmangi rreziqet për shëndetin dhe kërcënimet ndaj mirëqenies fizike dhe psikologjike ndërsa përdoren teknologjitë digjitale. Për të qenë në gjendje të mbroni veten dhe të tjerët nga rreziqet e mundshme në mjediset digjitale (p.sh. bullizmi kibernetik). Për të qenë të vetëdijshëm për teknologjitë digjitale për mirëqenien sociale dhe përfshirjen sociale.

| Nivelet e aftësisë | Bazë | | I ndërmjetëm | | I përparuar | | Tejet i specializuar | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 |
| | Në nivel bazë dhe me udhëzime, unë mund të:<br>• **bëj dallimin** midis mënyrave **të thjeshta** për të shmangur rreziqet shëndetësore dhe kërcënimet ndaj mirëqenies fizike dhe psikologjike ndërsa përdoren teknologjitë digjitale.<br>• **përzgjedh** mënyra **të thjeshta** për të mbrojtur veten nga rreziqet e mundshme në mjediset digjitale.<br>• **identifikoj** teknologji **të thjeshta** digjitale për mirëqenien sociale dhe përfshirjen sociale. | Në nivel bazë dhe i pavarur dhe me udhëzime të duhura kur është e nevojshme, unë mund të:<br>• **bëj dallimin** midis mënyrave **të thjeshta** për të shmangur rreziqet shëndetësore dhe kërcënimet ndaj mirëqenies fizike dhe psikologjike ndërsa përdoren teknologjitë digjitale.<br>• **përzgjedh** mënyra **të thjeshta** për të mbrojtur veten nga rreziqet e mundshme në mjediset digjitale.<br>• **identifikoj** teknologji **të thjeshta** digjitale për mirëqenien sociale dhe përfshirjen sociale. | Në mënyrë të pavarur dhe duke zgjidhur probleme të drejtpërdrejta, unë mund të:<br>• **shpjegoj** mënyrat **e përkufizuara mirë dhe rutinore** për të shmangur rreziqet për shëndetin dhe kërcënimet ndaj mirëqenies fizike dhe psikologjike ndërsa përdoren teknologjitë digjitale.<br>• **përzgjedh** mënyra **të përkufizuara mirë dhe rutinore** për të mbrojtur veten nga rreziqet në mjediset digjitale.<br>• **dëftoj** teknologji digjitale **të përkufizuara mirë dhe rutinore** për mirëqenien sociale dhe përfshirjen sociale. | Në mënyrë të pavarur, sipas nevojave të mia, dhe duke zgjidhur probleme të përkufizuara mirë dhe jorutinore, unë mund të:<br>• **shpjegoj** mënyra se si shmangen kërcënimet për shëndetin tim fizik dhe psikologjik lidhur me përdorimin e teknologjisë.<br>• **përzgjedh** mënyra për të mbrojtur veten dhe të tjerët nga rreziqet në mjediset digjitale.<br>• **diskutoj** për teknologjitë digjitale për mirëqenien sociale dhe përfshirjen sociale. | Përveç udhëzimit të të tjerëve, unë mund të:<br>• **tregoj** mënyra **të ndryshme** për të shmangur rreziqet për shëndetin dhe kërcënimet ndaj mirëqenies fizike dhe psikologjike ndërsa përdoren teknologjitë digjitale.<br>• **aplikoj** mënyra **të ndryshme** për të mbrojtur veten dhe të tjerët nga rreziqet në mjediset digjitale.<br>• **tregoj** teknologji **të ndryshme** digjitale për mirëqenien sociale dhe përfshirjen sociale. | Në nivel të përparuar, sipas nevojave të mia personale dhe të të tjerëve, dhe në kontekste komplekse, unë mund të:<br>• **dalloj** mënyrat **më të përshtatshme** për të shmangur rreziqet për shëndetin dhe kërcënimet ndaj mirëqenies fizike dhe psikologjike ndërsa përdoren teknologjitë digjitale.<br>• **përshtat** mënyrat **më të përshtatshme** për të mbrojtur veten dhe të tjerët nga rreziqet në mjediset digjitale.<br>• **ndryshoj** përdorimin e teknologjive digjitale për mirëqenie sociale dhe përfshirje sociale. | Në nivel tejet të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për probleme komplekse me përkufizim të kufizuar** që lidhen me shmangien e rreziqeve dhe kërcënimeve për shëndetin dhe mirëqenien gjatë përdorimit të teknologjive digjitale, mbrojtjen e vetes dhe të të tjerëve nga rreziqet në mjediset digjitale dhe përdorimin e teknologjive digjitale për mirëqenie sociale dhe përfshirje sociale.<br>• **integroj** njohuritë e mia **për të kontribuar në praktika dhe njohuri profesionale dhe udhëzoj të tjerët** në mbrojtjen e shëndetit. | Në nivelin më të përparuar dhe të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për të zgjidhur probleme komplekse me shumë faktorë ndërveprues** që lidhen me shmangien e rreziqeve dhe kërcënimeve për shëndetin dhe mirëqenien gjatë përdorimit të teknologjive digjitale, mbrojtjen e vetes dhe të të tjerëve nga rreziqet në mjediset digjitale dhe përdorimin e teknologjive digjitale për mirëqenie sociale dhe përfshirje sociale.<br>• **propozoj** ide dhe procese **të reja** në fushë. |
| **Shembuj të përdorimit**<br>01<br>Skenari i punësimit: Përdorimi i një llogarie të Twitter për të ndarë informacionet e mia për organizatën time | | | | | | | Mund të krijoj një kampanjë digjitale për rreziqet e mundshme për shëndetin nga përdorimi i Twitter për qëllime profesionale (p.sh. bullizmi, varësitë, mirëqenia fizike) që mund të ndahen dhe përdoren nga kolegët e tjerë dhe profesionistët në telefonat e tyre të mençur ose tabletët. | |
| **Shembuj të përdorimit**<br>02<br>Skenari i mësimit:<br>Përdorimi i platformës së mësimit digjital të shkollës për të ndarë informacione për temat e interesit | | | | | | | Mund të krijoj një blog për bullizmin kiberbetik dhe përjashtimin social për platformën e mësimit digjital të shkollës sime, që i ndihmon shokët e mi të klasës të njohin dhe të përballen me dhunën në mjediset digjitale. | |

## Fusha e kompetencës 4: Siguria

### 4.4 Mbrojtja e mjedisit

Për të qenë të vetëdijshëm për ndikimin mjedisor të teknologjive digjitale dhe përdorimit të tyre.

| Nivelet e aftësisë | Bazë 1 | Bazë 2 | I ndërmjetëm 3 | I ndërmjetëm 4 | I përparuar 5 | I përparuar 6 | Tejet i specializuar 7 | Tejet i specializuar 8 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Në nivel bazë dhe me udhëzime, unë mund të:<br>• **njoh** ndikimet **e thjeshta** mjedisore të teknologjive digjitale dhe përdorimit të tyre. | Në nivel bazë dhe i pavarur dhe me udhëzime të duhura kur është e nevojshme, unë mund të:<br>• **njoh** ndikimet **e thjeshta** mjedisore të teknologjive digjitale dhe përdorimit të tyre. | Në mënyrë të pavarur dhe duke zgjidhur probleme të drejtpërdrejta, unë mund të:<br>• **tregoj** ndikimet mjedisore **të përkufizuara mirë dhe rutinore** të teknologjive digjitale dhe përdorimit të tyre | Në mënyrë të pavarur, sipas nevojave të mia, dhe duke zgjidhur probleme të përkufizuara mirë dhe jorutinore, unë mund të:<br>• **diskutoj** për mënyrat e mbrojtjes së mjedisit nga ndikimi i teknologjive digjitale dhe përdorimit të tyre. | Përveç udhëzimit të të tjerëve, unë mund të:<br>• **tregoj** mënyra të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit nga ndikimi i teknologjive digjitale dhe përdorimit të tyre. | Në nivel të përparuar, sipas nevojave të mia personale dhe të të tjerëve, dhe në kontekste komplekse, unë mund të:<br>• **zgjedh** zgjidhjet **më të përshtatshme** për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimi i teknologjive digjitale dhe përdorimit të tyre. | Në nivel tejet të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për probleme komplekse me përkufizim të kufizuar** që lidhen me mbrojtjen e mjedisit nga ndikimi i teknologjive digjitale dhe përdorimi i tyre.<br>• **integroj** njohuritë e mia **për të kontribuuar në praktikën dhe njohuritë profesionale dhe të udhëzoj të tjerët** në mbrojtjen e mjedisit. | Në nivelin më të përparuar dhe të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për të zgjidhur probleme komplekse me shumë faktorë ndërveprues** që lidhen me mbrojtjen e mjedisit nga ndikimi i teknologjive digjitale dhe përdorimi i tyre.<br>• **propozoj** ide dhe procese **të reja** në fushë. |
| **Shembuj të përdorimit**<br>01<br>Skenari i punësimit:<br>Përdorimi i një llogarie të Twitter për të ndarë informacione për organizatën time | | | | | | | | Mund të krijoj një video të ilustruar që u përgjigjet pyetjeve për përdorimin e qëndrueshëm të pajisjeve digjitale në organizatat e sektorit tim, për t'u ndarë në Twitter dhe për t'u përdorur nga personeli dhe profesionistët e tjerë në sektor. |
| **Shembuj të përdorimit**<br>02<br>Skenari i mësimit:<br>Përdorimi i platformës së mësimit digjital të shkollës për të ndarë informacione për temat e interesit | | | | | | | | Mund të krijoj një eBook për t'iu përgjigjur pyetjeve për përdorimin e qëndrueshëm të pajisjeve digjitale në shkollë dhe shtëpi dhe ta ndaj në platformën e mësimit digjital të shkollës që të përdoret nga shokët e klasës dhe familjet e tyre. |

# Fusha e kompetencës 5: Zgjidhja e problemeve

## 5.1 Zgjidhja e problemeve teknike

Për të identifikuar problemet teknike gjatë operimit të pajisjeve dhe përdorimit të mjediseve digjitale dhe për t' i zgjidhur ato (nga gjetja e defekteve e deri tek problemet më komplekse).

| Nivelet e aftësisë | Bazë 1 | Bazë 2 | I ndërmjetëm 3 | I ndërmjetëm 4 | I përparuar 5 | I përparuar 6 | Tejet i specializuar 7 | Tejet i specializuar 8 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Në nivel bazë dhe me udhëzime, unë mund të:<br>• **identifikoj** probleme teknike **të thjeshta** gjatë përdorimit të pajisjeve dhe përdorimit të mjediseve digjitale, dhe<br>• **identifikoj** zgjidhje **të thjeshta** për t'i zgjidhur ato. | Në nivel bazë dhe i pavarur dhe me udhëzime të duhura kur është e nevojshme, unë mund të:<br>• **identifikoj** probleme teknike **të thjeshta** gjatë përdorimit të pajisjeve dhe përdorimit të mjediseve digjitale, dhe<br>• **identifikoj** zgjidhje **të thjeshta** për t'i zgjidhur ato. | Në mënyrë të pavarur dhe duke zgjidhur probleme të drejtpërdrejta, unë mund të:<br>• **dëftoj** problemet teknike **të përkufizuara mirë dhe rutinore** gjatë përdorimit të pajisjeve dhe mjediseve digjitale, dhe<br>• **përzgjedh** zgjidhje **të përkufizuara mirë dhe rutinore** për to. | Në mënyrë të pavarur, sipas nevojave të mia, dhe duke zgjidhur probleme të përkufizuara mirë dhe jorutinore, unë mund të:<br>• **bëj dallimin** midis problemeve teknike gjatë përdorimit të pajisjeve dhe mjediseve digjitale, dhe<br>• **përzgjedh** zgjidhjet për to. | Përveç udhëzimit të të tjerëve, unë mund të:<br>• **vlerësoj** problemet teknike gjatë përdorimit të mjediseve digjitale dhe punës me pajisje digjitale, dhe<br>• **aplikoj** zgjidhje të ndryshme për to. | Në nivel të përparuar, sipas nevojave të mia personale dhe të të tjerëve, dhe në kontekste komplekse, unë mund të:<br>• **vlerësoj** problemet teknike gjatë përdorimit të pajisjeve dhe mjediseve digjitale, dhe<br>• **zgjidh** ato me zgjidhjet **më të përshtatshme**. | Në nivel tejet të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për probleme komplekse me përkufizim të kufizuar** që lidhen me probleme teknike gjatë përdorimit të pajisjeve dhe përdorimit të mjediseve digjitale.<br>• **integroj** njohuritë e mia **për të kontribuuar në praktikën dhe njohuritë profesionale dhe të udhëzoj të tjerët** në zgjidhjen e problemeve teknike. | Në nivelin më të përparuar dhe të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për të zgjidhur probleme komplekse me shumë faktorë ndërveprues** që lidhen me probleme teknike gjatë përdorimit të pajisjeve dhe përdorimit të mjediseve digjitale.<br>• **propozoj** ide dhe procese **të reja** në fushë. |
| **Shembuj të përdorimit**<br>01<br>Skenari i punësimit:<br>Përdorimi i një platforme të mësimit digjital për të përmirësuar mundësitë e mia të karrierës | Ndihmuar nga një kolege nga departamenti i TI-së:<br>mund të identifikoj një problem të thjeshtë teknik nga një listë e atyre që mund të paraqiten gjatë përdorimit të një platforme të mësimit digjital dhe<br>mund të identifikoj se cili lloj i mbështetjes së TI-së mund ta zgjidhë atë. | | | | | | | |
| **Shembuj të përdorimit**<br>02<br>Skenari i mësimit:<br>Përdorimi i një platforme të mësimit digjital për të përmirësuar shkathtësitë e mia në matematikë | Ndihmuar nga një shoqe:<br>mund të identifikoj një problem të thjeshtë teknik nga një listë e atyre që mund të paraqiten gjatë përdorimit të një platforme të mësimit digjital dhe<br>mund të identifikoj se cili lloj i mbështetjes së TI-së mund ta zgjidhë atë. | | | | | | | |

**Fusha e kompetencës 5: Zgjidhja e problemeve 5.2 Identifikimi i nevojave dhe përgjigjeve teknologjike**

Për të vlerësuar nevojat dhe për të identifikuar, vlerësuar, përzgjedhur dhe përdorur mjetet digjitale dhe përgjigjet e mundshme teknologjike për t' i zgjidhur ato. Për të rregulluar dhe përshtatur mjediset digjitale për nevoja personale (p.sh. qasshmëria).

| Nivelet e aftësisë | Bazë | | I ndërmjetëm | | I përparuar | | Tejet i specializuar | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 |
| | Në nivel bazë dhe me udhëzime, unë mund të:<br>• **identifikoj** nevojat dhe<br>• **njoh** mjetet **e thjeshta** digjitale dhe përgjigjet e mundshme teknologjike për të zgjidhur ato nevoja.<br>• **zgjedh** mënyra **të thjeshta** për të rregulluar dhe përshtatur mjediset digjitale ndaj nevojave personale. | Në nivel bazë dhe i pavarur dhe me udhëzime të duhura kur është e nevojshme, unë mund të:<br>• **identifikoj** nevojat, dhe<br>• **njoh** mjetet **e thjeshta** digjitale dhe përgjigjet e mundshme teknologjike për të zgjidhur ato nevoja.<br>• **zgjedh** mënyra **të thjeshta** për të rregulluar dhe përshtatur mjediset digjitale ndaj nevojave personale. | Në mënyrë të pavarur dhe duke zgjidhur probleme të drejtpërdrejta, unë mund të:<br>• **dëftoj** nevojat **e përkufizuara mirë dhe rutinore**, dhe<br>• **përzgjedh** mjetet digjitale **të përkufizuara mirë dhe rutinore** dhe përgjigjet e mundshme teknologjike për të zgjidhur ato nevoja.<br>• **përzgjedh** mënyra **të përkufizuara mirë dhe rutinore** për të rregulluar dhe përshtatur mjediset digjitale ndaj nevojave personale. | Në mënyrë të pavarur, sipas nevojave të mia, dhe duke zgjidhur probleme të përkufizuara mirë dhe jorutinore, unë mund të:<br>• **shpjegoj** nevojat, dhe<br>• **përzgjedh** mjetet digjitale dhe përgjigjet e mundshme teknologjike për të zgjidhur ato nevoja.<br>• **përzgjedh** mënyra për të rregulluar dhe përshtatur mjediset digjitale ndaj nevojave personale. | Përveç udhëzimit të të tjerëve, unë mund të:<br>• **vlerësoj** nevojat,<br>• **aplikoj** mjete **të ndryshme** digjitale dhe përgjigjet e mundshme teknologjike për të zgjidhur ato nevoja.<br>• **përdor** mënyra **të ndryshme** për të rregulluar dhe përshtatur mjediset digjitale ndaj nevojave personale. | Në nivel të përparuar, sipas nevojave të mia personale dhe të të tjerëve, dhe në kontekste komplekse, unë mund të:<br>• **vlerësoj** nevojat,<br>• **zgjedh** mjetet digjitale dhe përgjigjet e mundshme teknologjike **më të përshtatshme** për të zgjidhur ato nevoja.<br>• **vendos** për mënyrat **më të përshtatshme** për të rregulluar dhe përshtatur mjediset digjitale ndaj nevojave personale | Në nivel tejet të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për probleme komplekse me përkufizim të kufizuar** duke përdorur mjetet digjitale dhe përgjigjet e mundshme teknologjike dhe t'i përshtat dhe personalizoj mjediset digjitale ndaj nevojave personale.<br>• **integroj** njohuritë e mia **për të kontribuar në praktika dhe njohuri profesionale dhe udhëzoj të tjerët** lidhur me identifikimin e nevojave dhe përgjigjeve teknologjike. | Në nivelin më të përparuar dhe të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për të zgjidhur probleme komplekse me shumë faktorë ndërveprues** duke përdorur mjete digjitale dhe përgjigjet e mundshme teknologjike, dhe të përshtat dhe personalizoj mjediset digjitale për nevoja personale.<br>• **propozoj** ide dhe procese **të reja** në fushë. |
| **Shembuj të përdorimit**<br>01<br>Skenari i punësimit:<br>Përdorimi i një platforme të mësimit digjital për të përmirësuar mundësitë e mia të karrierës | | Me ndihmën e një koleges nga departamenti i Burimeve Njerëzore me të cilin mund të konsultohem sa herë që kam nevojë:<br>nga një listë e kurseve në linjë që departamenti i Burimeve Njerëzore ka përgatitur, mund të identifikoj ato që i përshtaten nevojave të mia për përparim në karrierë.<br>gjatë leximit të materialit studimor në ekran në tabletin tim, mund ta rrit madhësinë e shkronjave për lexim më të lehtë. | | | | | | |
| **Shembuj të përdorimit**<br>02<br>Skenari i mësimit:<br>Përdorimi i një platforme të mësimit digjital për të përmirësuar shkathtësitë e mia në matematikë | | Në klasë me mësimdhënësen time me të cilën mund të konsultohem sa herë që kam nevojë:<br>nga një listë e burimeve digjitale për matematikë nga mësimdhënësja ime, mund të zgjedh një lojë arsimore që mund të më ndihmojë për të praktikuar shkathtësitë e mia të matematikës.<br>mund ta rregulloj ndërfaqen e lojës që të përputhet me gjuhën time amtare. | | | | | | |

## Fusha e kompetencës 5: Zgjidhja e problemeve   5.3 Përdorimi kreativ i teknologjive digjitale

Për të përdorur mjetet dhe teknologjitë digjitale për të krijuar njohuri dhe për të sjellë risi në procese dhe produkte. Për t' u angazhuar në mënyrë individuale dhe kolektive në përpunimin kognitiv për të kuptuar dhe zgjidhur problemet konceptuale dhe situatat problematike në mjediset digjitale.

| Nivelet e aftësisë | Bazë 1 | Bazë 2 | I ndërmjetëm 3 | I ndërmjetëm 4 | I përparuar 5 | I përparuar 6 | Tejet i specializuar 7 | Tejet i specializuar 8 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Në nivel bazë dhe me udhëzime, unë mund të:<br>• **identifikoj** mjete dhe teknologji **të thjeshta** digjitale që mund të përdoren për të krijuar njohuri dhe për të sjellë risi në procese dhe produkte.<br>• **tregoj interes** në mënyrë individuale dhe kolektive për përpunimin **e thjeshtë** kognitiv për të kuptuar dhe zgjidhur probleme **të thjeshta** konceptuale dhe situata problematike në mjedise digjitale. | Në nivel bazë dhe i pavarur dhe me udhëzime të duhura kur është e nevojshme,, unë mund të:<br>• **identifikoj** mjete dhe teknologji **të thjeshta** digjitale që mund të përdoren për të krijuar njohuri dhe për të sjellë risi në procese dhe produkte<br>• **ndjek** në mënyrë individuale dhe kolektive përpunimin **e thjeshtë** kognitiv për të kuptuar dhe zgjidhur probleme **të thjeshta** konceptuale dhe situata problematike në mjediset digjitale. | Vetë dhe duke zgjidhur probleme të drejtpërdrejta, unë mund të:<br>• **përzgjedh** mjete dhe teknologji digjitale që mund të përdoren për të krijuar njohuri **të përkufizuara mirë** dhe procese dhe produkte novatore **të përkufizuara mirë**.<br>• **angazhohem** në mënyrë individuale dhe kolektive në përpunime kognitive për të kuptuar dhe zgjidhur problemet konceptuale **të përkufizuara mirë dhe rutinore** dhe situatat problematike në mjediset digjitale. | Në mënyrë të pavarur, sipas nevojave të mia, dhe duke zgjidhur probleme të përkufizuara mirë dhe jorutinore, unë mund të:<br>• **bëj dallimin** midis mjeteve dhe teknologjive digjitale që mund të përdoren për të krijuar njohuri dhe për të sjellë risi në procese dhe produkte.<br>• **angazhohem** në mënyrë individuale dhe kolektive në përpunimin kognitiv për të kuptuar dhe zgjidhur problemet konceptuale dhe situatat problematike në mjediset digjitale. | Përveç udhëzimit të të tjerëve, unë mund të:<br>• **përdor** mjete dhe teknologji **të ndryshme** digjitale për të krijuar njohuri dhe për të dale me procese dhe produkte novatore.<br>• **aplikoj** në mënyrë individuale dhe kolektive përpunimin kognitiv për të zgjidhur probleme **të ndryshme** konceptuale dhe situata problematike në mjediset digjitale. | Në nivel të përparuar, sipas nevojave të mia personale dhe të të tjerëve, dhe në kontekste komplekse, unë mund të:<br>• **përshtat** mjetet dhe teknologjitë digjitale **më të përshtatshme** për të krijuar njohuri dhe për të dalë me procese dhe produkte novatore.<br>• **zgjidh** në mënyrë individuale dhe kolektive problemet konceptuale dhe situatat problematike në mjediset digjitale. | Në nivel tejet të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për probleme komplekse me përkufizim të kufizuar** duke përdorur mjetet dhe teknologjitë digjitale.<br>• **integroj** njohuritë e mia **për të kontribuar në praktika dhe njohuri profesionale dhe udhëzoj të tjerët** lidhur me përdorimin kreativ të teknologjive digjitale. | Në nivelin më të përparuar dhe të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për të zgjidhur probleme me shumë faktorë ndërveprues** duke përdorur mjetet dhe teknologjitë digjitale.<br>• **propozoj** ide dhe procese **të reja** në fushë. |
| **Shembuj të përdorimit**<br>01<br>Skenari i punësimit:<br>Përdorimi i një platforme të mësimit digjital për të përmirësuar mundësitë e mia të karrierës | | | Vetë:<br>Mund të përdor një forum të MOOC për të kërkuar informacione të përkufizuara mirë në një kurs që ndjek dhe mund të përdor mjetet e tij (p.sh. blogun, wiki) për të krijuar një hyrje të re për të këmbyer më shumë informacione.<br>Mund të angazhohem në një ushtrim bashkëpunues me studentët e tjerë duke përdorur mjetin e hartës mendore të MOOC për të kuptuar një problem konkret në një mënyrë tjetër.<br>Mund të rregulloj probleme si identifikimi i shtrimit të një pyetje ose komentimi në vendin e gabuar. | | | | | |
| **Shembuj të përdorimit**<br>02<br>Skenari i mësimit:<br>Përdorimi i platformës digjitale arsimore për të përmirësuar shkathtësitë e mia në matematikë | | | Vetë:<br>Mund të përdor forumin e MOOC për të kërkuar informacione të përkufizuara mirë në një kurs që ndjek dhe mund të përdor mjetet e tij (p.sh. blogun, wiki) për të krijuar një hyrje të re për të këmbyer më shumë informacione.<br>Mund të angazhohem në ushtrimet e MOOC që përdorin simulime për të praktikuar një problem të matematikës të cilin nuk kam arritur ta zgjidh saktë në shkollë. Diskutimi i ushtrimeve në bisedë me studentët e tjerë më ka ndihmuar që t'i qasem më ndryshe problemit dhe që të përmirësoj shkathtësitë e mia.<br>Mund të rregulloj probleme si identifikimi i shtrimit të një pyetje ose komentimi në vendin e gabuar. | | | | | |

# Fusha e kompetencës 5: Zgjidhja e problemeve

## 5.4 Identifikimi i mangësive në kompetencën digjitale

Për të kuptuar se kur kompetenca digjitale e dikujt duhet të përmirësohet ose përditësohet. Për të qenë në gjendje për të mbështetur të tjerët me zhvillimin e tyre të kompetencës digjitale. Për të kërkuar mundësi për vetë-zhvillim dhe përditësim të vazhdueshëm me evolucionin digjital.

| Nivelet e aftësisë | Bazë 1 | Bazë 2 | I ndërmjetëm 3 | I ndërmjetëm 4 | I përparuar 5 | I përparuar 6 | Tejet i specializuar 7 | Tejet i specializuar 8 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Në nivel bazë dhe me udhëzime, unë mund të:<br>• **kuptoj** se kur kompetenca ime digjitale duhet të përmirësohet ose të përditësohet.<br>• **identifikoj** se ku të kërkoj mundësi për vetë-zhvillim dhe përditësim të vazhdueshëm me evolucionin digjital. | Në nivel bazë dhe i pavarur dhe me udhëzime të duhura kur është e nevojshme, unë mund të:<br>• **kuptoj** se kur kompetenca ime digjitale duhet të përmirësohet ose të përditësohet,<br>• **identifikoj** se ku të kërkoj mundësi për vetë-zhvillim dhe përditësim të vazhdueshëm me evolucionin digjital. | Në mënyrë të pavarur dhe duke zgjidhur probleme të drejtpërdrejta, unë mund të:<br>• **shpjegoj** se kur kompetenca ime digjitale duhet të përmirësohet ose të përditësohet,<br>• **dëftoj** se ku të kërkohet për mundësi **të përkufizuara mirë** për vetëzhvillim dhe përditësim të vazhdueshëm me evolucionin digjital. | Në mënyrë të pavarur, sipas nevojave të mia, dhe duke zgjidhur probleme të përkufizuara mirë dhe jorutinore, unë mund të:<br>• **diskutoj** se kur kompetenca ime digjitale duhet të përmirësohet ose të përditësohet,<br>• **dëftoj** se si të mbështeten të tjerët për të zhvilluar kompetencën e tyre digjitale.<br>• **dëftoj** se ku duhet të kërkohet për mundësi për vetëzhvillim dhe përditësim të vazhdueshëm me evolucionin digjital. | Përveç udhëzimit të të tjerëve, unë mund të:<br>• **tregoj** se kur kompetenca ime digjitale duhet të përmirësohet ose të përditësohet,<br>• **ilustroj** mënyra të ndryshme për të mbështetur të tjerët në zhvillimin e kompetencës së tyre digjitale.<br>• **propozoj** mundësi të ndryshme të identifikuara për vetë-zhvillim dhe përditësim të vazhdueshëm me evolucionin digjital. | Në nivel të përparuar, sipas nevojave të mia personale dhe të të tjerëve, dhe në kontekste komplekse, unë mund të:<br>• **vendos** se cilat janë mënyrat **më të përshtatshme** për të përmirësuar ose përditësuar nevojat personale për kompetencë digjitale.<br>• **vlerësoj** zhvillimin e kompetencës digjitale të të tjerëve.<br>• **zgjedh** mundësitë **më të përshtatshme** për vetë-zhvillim dhe përditësim të vazhdueshëm me zhvillimet e reja. | Në nivel tejet të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për probleme komplekse me përkufizim të kufizuar** që lidhen me përmirësimin e kompetencës digjitale, dhe të gjej mundësi për vetëzhvillim dhe për përditësim me zhvillimet e reja.<br>• **integroj** njohuritë e mia **për të kontribuar në praktikën dhe njohuritë profesionale dhe të udhëzoj të tjerët** për identifikimin e mangësive në kompetencën e tyre digjitale. | Në nivelin më të përparuar dhe të specializuar, unë mund të:<br>• **krijoj zgjidhje për të zgjidhur probleme komplekse me shumë faktorë ndërveprues** që lidhen me përmirësimin e kompetencës digjitale dhe gjetjen e mundësive për vetëzhvillim dhe përditësim për të qenë në hap me evolucionin digjital.<br>• **propozoj** ide dhe procese **të reja** në fushë. |
| **Shembuj të përdorimit**<br>01<br>Skenari i punësimit:<br>Përdorimi i një platforme të mësimit digjital për të përmirësuar mundësitë e mia të karrierës | | | | Mund të diskutoj kompetencën digjitale që më duhet për të qenë në gjendje të përdor kurset e MOOC për karrierën time profesionale me një këshilltare për punësim.<br>Mund t'i tregoj asaj se ku i gjej dhe i përdor kurset MOOC për të zhvilluar dhe për të përditësuar nivelin e aftësisë sime në kompetencat digjitale për ta përmirësuar karrierën time profesionale.<br>Mund të merrem me çfarëdo çështje derisa i kryej këto aktivitete, p.sh. mund të vlerësoj nëse mjediset e reja digjitale që i gjej gjatë shfletimit janë mjete të përshtatshme për përmirësimin e nivelit të aftësisë së kompetencës sime digjitale. | | | | |
| **Shembuj të përdorimit**<br>02<br>Skenari i mësimit:<br>Përdorimi i një platforme të mësimit digjital për të përmirësuar shkathtësitë e mia në matematikë | | | | Mund të diskutoj me një shoqe kompetencën digjitale që më duhet për të përdorur mjetet e një kursi MOOC për studimet e mia në matematikë.<br>Mund t'i tregoj mësimdhënëses se ku i gjej dhe i përdor kurset MOOC sipas nevojave të mia për mësim.<br>Mund t'i tregoj se cilat aktivitete digjitale dhe faqe shfletoj për ta mbajtur kompetencën time digjitale të përditësuar që të mund të përfitoj maksimalisht nga platformat e mësimit digjital për nevojat e mia të të nxënit.<br>Mund të merrem me çfarëdo çështje gjatë kohës që kryej këto aktivitete, si vlerësimi nëse mjediset digjitale që shfaqen gjatë shfletimit janë të duhurat për përmirësimin e kompetencës sime digjitale dhe përfitimin maksimalisht nga MOOC. | | | | |

Europe Direct është një shërbim që ju ndihmon të gjeni përgjigjet për pyetjet tuaja lidhur me Bashkimin Evropian.

Numri falas (*):

**00 800 6 7 8 9 10 11**

(*) Informacionet jepen falas, e po ashtu edhe pjesa më e madhe e telefonatave janë falas (ndonëse disa operatorë, kabina telefonike ose hotele mund të aplikojnë tarifa).

Më shumë informacione për Bashkimin Evropian janë të disponueshme në internet (http://europa.eu).

## SI TË MERREN PUBLIKIMET E BE-së

### Publikimet falas:

- një kopje: përmes Librarisë së BE-së (http://bookshop.europa.eu);
- më shumë se një kopje ose posterët/hartat:
  - nga përfaqësimet e Bashkimit Evropian (http://ec.europa.eu/represent_en.htm);
  - nga delegacionet në vendet jo anëtare të BE-së (http://eeas.europa.eu/delegations/index_en.htm);
  - duke e kontaktuar drejtpërdrejt shërbimin e Europe Direct (http://europa.eu/europedirect/index_en.htm)
  - ose duke telefonuar 00 800 6 7 8 9 10 11 (numër telefoni falas për thirrje nga kudo në BE) (*).

(*) Informacionet jepen falas, e po ashtu edhe pjesa më e madhe e telefonatave janë falas (ndonëse disa operatorë, kabina telefonike ose hotele mund t'ju tarifojnë).

### Publikimet me pagesë:

- përmes Librarisë së BE-së (http://bookshop.europa.eu).

KJ-NA-28558-EN-N

## Misioni i JRC-së

Si shërbim për shkencë dhe njohuri i Komisionit Evropian, misioni i Qendrës së Përbashkët për Kërkime është të mbështesë politikat e BE-së me dëshmi të pavarura gjatë gjithë ciklit të politikave.

Qendra shkencore e BE-së
ec.europa.eu/jrc

@EU_ScienceHub

Qendra shkencore e BE-së - Qendra e Përbashkët për kërkime

Qendra e Përbashkët për kërkime

Qendra shkencore e BE-së

Publications Office

doi:10.2760/38842

ISBN 978-92-79-68006-9